

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5930  
E enjte, 14 nëntor 2019  
çmimi 0.40 €

Formimi i Kuvendit dhe  
qeverisë së re nuk  
ndikohet nga ankesat  
në Kushtetuese | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

LËVIZJA VETËVENDOSJE DHE LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS PRITET T'I HARMONIZOJNË  
QËNDRIMET RRETH DIALOGUT KOSOVË - SERBI | FAQE 3

**ANALISTËT:**

## LV-ja DHE LDK-ja DUHET T'I TEJKALOJNË DALLIMET PËR DIALOGUN ME SERBINË

Njohësit e rrethanave politike kanë bërë me dije se Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës duhet t'i tejkalojnë dallimet partiake për dialogun me Serbinë. Analistët Behxhet Shala dhe Imer Mushkolaj kanë vlerësuar për "Epokën e re" se këto dy parti politike duhet të heqin dorë nga qëndrimet që i kanë pasur sa kanë qenë në opozitë për këtë çështje. Sipas tyre, as LV-ja dhe as LDK-ja nuk e kanë luksin që për shkak të dialogut Kosovë - Serbi ta pengojnë arritjen e marrëveshjes së koalicionit për bashkëqeverisje



### OPINION

**KUSH E FSHEHU  
JASTËKUN ME JARGË QË  
ISHTE NË DHOMËN E  
KRIMIT? F. 08**



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

### AKTUALE

**NË LAPARASKOPI KRYHET NJË  
NDËRHYRJE E KOMPLIKUAR NË  
VESHKË F. 3**

**NIVELI I UJIT NË LIQENIN E  
BATLLAVËS ËSHTË 8.50 METRA  
NËN KUOTËN MAKSIMALE F. 6**

**SOT I JEPET LAMTUMIRA  
E FUNDIT REGJISORES**



### EKONOMI

**SUBVENCIONET PËR EFIÇIENCË  
TË ENERGJISË NË KOSOVË  
KAPIN SHIFRËN 20.6 MILIONË  
DOLLARË F. 9**

**KDI-ja: MINISTRIA E  
INFRASTRUKTURËS QË 12 VJET  
NUK PO I PËRFUNDON PUNIMET  
NË DY RRUGË NACIONALE F. 9**

FLET PËR "EPOKËN E RE", KOORDINATORI NACIONAL PËR  
KULTURË, RINI DHE SPORT, REXHEP HOTI

## PROGRAMI NACIONAL PËR RININË KA MARRË MBËSHTETJEN E SPEKTRIT POLITIK

| FAQE 4-5

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)


**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Lavrovi krahason Kosovën me Krimenë

PRISHINË, 11 NËNTOR - Ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov ka bërë krahasim në mes të Krimesë dhe Kosovës, teksa ka kritikuar Perëndimin në një takim pyetje-përgjigje, të organizuar në kuadër të Forumit të Paqes në Paris. Aika akuzuar shtetet perëndimore për standarde të dyfishta, meqë sipas Lavrovit "kur diçka është në interes të Perëndimit, ata e konsiderojnë të drejtën e njerëzve për vetëvendosje si të shenjtë, mirëpo kur diçka nuk lidhet me interesat e

tyre, atëherë ata e shpallin këtë të drejtë si të paligjshme". Ilustrim i këtyre deklaratave ka qenë Kosova dhe Krimea. "Krahasoni Kosovën dhe Krimenë: një referendum është mbajtur në Krime dhe nuk ka pasur referendum në Kosovë. Megjithatë Kosova është njohur menjëherë si shtet i pavarur nga shumica e vendeve perëndimore", ka thënë ai. Rusia ka aneksuar Gadishullin e Krimesë nga Ukraina më 2014.

Referendumi i mbajtur në këtë rajon është cilësuar si i paligjshëm nga Ukraina dhe fuqitë perëndimore. Shtetet e Bashkuara dhe vendet perëndimore kanë sanksionuar Rusinë për këtë veprim, derisa kanë vazhduar këto masa edhe për shkak të rolit të separatistëve rusë në luftimet me forcat qeveritare në lindje të Ukrainës. Si pasojë e këtyre luftimeve kanë vdekur mbi 10,300 persona. Pavarësia e Kosovës është shpallur



më 17 shkurt të vitit 2008. Sipas Ministrisë së Jashtme të

Kosovës, shtetësia e këtij vendi është njohur nga 116 shtete.

# Gjermani mbështet Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut për nisjen e negociatave

Ministri i Jashtëm Haiko Mass, ka thënë se Gjermania mbetet në qëndrimin se Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut meritojnë datën për fillim të negociatave për anëtarësim me Bashkimin Evropian, pavarësisht ndryshimeve të iniciuara nga Franca

Shkup, 13 nëntor - Ministri i Jashtëm i Gjermanisë Haiko Mass, të mërkurën ka qëndruar për vizitë zyrtare në Shkup, ku ka thënë se Gjermania mbetet në qëndrimin se Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria meritojnë datën për fillim të negociatave për anëtarësim me Bashkimin Evropian, pavarësisht ndryshimeve të iniciuara nga Franca e që pritet të ndodhin në metodologjinë e anëtarësimit. Ministri i Jashtëm gjerman, Haiko Mas inkurajoi

Maqedoninë e Veriut të vazhdojë me reformat në drejtësi, luftën kundër korrupsionit dhe kthimin e shtetit të së drejtës, duke siguruar se për këtë ka mbështetjen dhe ndihmën e plotë të Berlinit. Ndërkaq Ministri i Jashtëm i Maqedonisë Veriore, Nikolla Dimitrov duke argumentuar se BE-ja nuk guxon të neglizhojë vendin pas kompromiseve të bëra, rithekson se pavarësisht fqinjësisë së mirë që ka Maqedonia e Veriut me



Shqipërinë, kur bëhet fjalë për anëtarësimin në BE, është më mirë që secili shtet të vlerësohet ndaras, në bazë të meritave të veta. "Askush në BE nuk e konteston

perspektivën evropiane të Maqedonisë së Veriut. Tani mbetet ta shfrytëzojmë ndihmën për Maqedoninë e Veriut dhe për të ardhmen. Këtu bën pjesë edhe ndihma jonë bilaterale që duam

ta zgjerojmë. Porosia jonë është e qartë: na lejoni së bashku të ecim në këtë rrugë! Jemi në dispozicionin tuaj", deklaroi Haiko Mas, ministër i Jashtëm i Gjermanisë. Ndërsa ministri i Jashtëm i Maqedonisë Veriore, Nikolla Dimitrov, ka kërkuar që Shkupi e Tirana të vlerësohen ndaras. "Parimi bazë në procesin e anëtarësimit është: secili sipas arritjeve në reforma. Nëse i grupojmë vendosim shtetet në paketë dhe i bëjmë të varura nga diçka që nuk është në kontroll të tyre atëherë humb logjika e anëtarësimit. Si fqinjë të mirë kemi interes që edhe Shqipëria dhe fqinjët tjerë të shkojnë përpara, por gjithashtu vlerësojmë se secili shtet duhet të vlerësohet veçmas", tha Nikolla Dimitrov, ministër i Jashtëm i Maqedonisë së Veriut.

## Basha: Nga kjo krizë nuk dilet pa zgjidhur krizën e ekonomisë



Tiranë, 13 nëntor - Kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha ka zhvilluar një bashkëbisedim me bizneset e vogla në Fier. Basha tha se kriza që po kalon vendi nuk ka kursyer biznesin e vogël. "Dyqanet s gjithë vendit janë bosh njësoj si xhepat dhe arka e shtetit. Kjo rezultat i keqqeveris-

jes dhe taksave të larta. Nga kjo krizë nuk dilet pa zgjidhur krizën e ekonomisë dhe faktori kryesor i kësaj zgjidhje është biznesi i vogël. Ndryshe nga fasada e kësaj qeverie, për mua dhe PD-në do të jetë në qendër të ofertës tonë, çlirimi i biznesit. Qeveria e PD-së do të jetë qeveri që ju dëgjon dhe ju mbështet. Ne kemi një platformë të qartë për

biznesin e vogël për ta çliruar nga taksidarët", u shpreh kryedemokrati Basha. Basha tha se investimet e vetme të kësaj qeverie, janë avionë për shfaqje bajate që duken e zhduken. "Nuk flasim dot për një investim të huaj perëndimor përveç shfaqjeve bajate me mashtrime avionësh që duken e zhduken

nga linja ajrore e Turkish Airlines por Iyer me bojën e Edi Ramës si Air Albania që ndonëse është një sjaesë shume e dyshimtë papritur na ka gjetur para për të financuar e për t'i vënë emrin stadiumit. Se ku i bëri ato para hajde merre me mend. Por e rëndësishme është kjo që nuk kemi asnjë investim serioz të huaj", u shpreh Basha.

## Deputetët e opozitës kërkojnë ligj antikomunist në politikë

TIRANË, 13 NËNTOR - Deputetët e opozitës kanë depozituar një propozim për të kthyer në ligj dekomunistizimin e politikës, shtetit dhe funksionarëve të lartë në vend. Deputeti i Grupit Parlamentar demokrat, Myslim Murrizi thekson se ka ardhur koha që të ndahet me ligj drejtimi i shtetit dhe qeverisë nga ish-komunistët. Propozimi mban firmat e 20

deputetëve të opozitës parlamentare. "Sot, në emër të 20 deputetëve të opozitës depozituam një propozim për ligj të dekomunistizimit të politikës, shtetit dhe funksionarëve të lartë që drejtojnë Shqipërinë. Një ligj që është belbëzuar nga disa vemje si kalë beteje, por kurrë nuk kanë guxuar prej 29 vitesh sepse secili ka menduar

të ruajë veten. Ka ardhur koha, bile jemi shumë vonë, që të ndajmë me ligj drejtimin e shtetit, politikës, qeverisë dhe administratës së lartë shtetërore nga komunizmi, komunistët dhe ish-shërbëtorët e tyre gjakatarë që kanë përdhosur e masakruar shqiptarët në emër të partisë prej 28 nëntorit 1944 deri më 8 dhjetor 1990", shprehet Murrizi.



Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës pritet t'i harmonizojnë qëndrimet rreth dialogut Kosovë - Serbi

## Analistët: LV-ja dhe LDK-ja duhet t'i tejkalojnë dallimet për dialogun me Serbinë

Njohësit e rrethanave politike kanë bërë me dije se Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës duhet t'i tejkalojnë dallimet partiake për dialogun me Serbinë. Analistët Behxhet Shala dhe Imer Mushkolaj kanë vlerësuar për "Epokën e re" se këto dy parti politike duhet të heqin dorë nga qëndrimet që i kanë pasur sa kanë qenë në opozitë për këtë çështje. Sipas tyre, as LV-ja e as LDK-ja nuk e kanë luksin që, për shkak të dialogut Kosovë - Serbi, ta pengojnë arritjen e marrëveshjes së koalicionit për bashkëqeverisje

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Njohësit e rrethanave politike besojnë se Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) do ta gjejnë një kompromis për dialogun Kosovë - Serbi. Behxhet Shala dhe Imer Mushkolaj kanë deklaruar për gazetën "Epoka e re" se këto dy parti janë të detyruara t'i harmonizojnë qëndrimet rreth kësaj çështje nëse duan që të bashkëqeverisin. "Këto dy subjekt politike për këtë çështje kanë pasur qëndrime të papajtueshme. LDK-ja ka kërkuar vazhdimisht që dialogu me Serbinë të afatizohet, pra të ketë një fillim dhe një fund, kurse LV-ja asnjëherë nuk e ka pranuar përmbajtjen e këtij dialogu. Pra, ky subjekt politik e ka kundërshtuar edhe mënyrën e dialogimit dhe formatin e këtij procesi", ka thënë për "Epokën e re" analisti Behxhet Shala.

Ai ka bërë me dije se këto dy pati politike duhet të heqin dorë nga qëndrimet që i kanë pasur sa kanë qenë në opozitë. "Tash meqenëse duhet të bëhen bashkë në qeverinë e re, këto dy subjekte politike nuk kanë qare pa e gjetur një mes për këtë çështje. Sikurse Vetëvendosja dhe z. Kurti si kryeministër i ardhshëm nuk do të mund t'i mbajnë pozicionet e

mëparshme. Qëndrimet e mëhershme të Kurtit kanë qenë qëndrime opozitare, kurse në opozitë duhet të thuhet fjalë të tjera", është shprehur Shala, duke shtuar se procesi i dialogut Kosovë - Serbi është në një fazë ku të dyja partitë duhet të lëvizin nga pozicionet e tyre dhe të gjejnë një mes i cili nuk do t'i dëmtonte interesat e Republikës së Kosovës. "Tani nuk do të kenë shumë hapësirë manovrimi as LDK-ja e as LV-ja, sepse në këtë proces fjalën kryesore do ta kenë ndërkombëtarët. Mendoj se ata tashmë e kanë bërë një draft të marrëveshjes ku përcaktohet se çka do të përmbajë ajo marrëveshje. Nëse LV-ja insiston në mënyrën e të bërit të këtij dialogu sipas parimeve të veta, atëherë mendoj se ndërkombëtarët do ta kërkojnë një partner tjetër për bisedime. Pra, mendoj se partitë do të largohen nga qëndrimet që kanë pasur më herët dhe t'u përshtaten rrethanave të reja, por gjithnjë duke pasur interesin e Kosovës", ka thënë Shala.

Edhe analisti tjetër politik Imer Mushkolaj ka deklaruar për gazetën se dy partitë që tashmë i kanë filluar bisedimet për ta formuar qeverinë e re duhet të arrijnë pajtueshmëri rreth kësaj çështje. "Besoj se LDK-ja dhe LV-ja do të mund ta arrijnë pajtimin rreth dialogut. Në masë të



madhe partitë pajtohen rreth asaj se si të vazhdojë procesi. Qasja e LV-së është më e ngurtë, në kuptimin e një skanimit që ajo kërkon për të gjitha marrëveshjet e arritura, e ndër këto marrëveshje më e rëndësishmja është ajo e nënshkruar nga ish-kryeministri Isa Mustafa në vitin 2015", ka thënë Mushkolaj. Ai ka treguar se LV-ja dhe LDK-ja nuk e kanë luksin që për shkak të dialogut Kosovë - Serbi ta pengojnë arritjen e marrëveshjes së koalicionit për bashkëqeverisje. "Qasja e këtyre dy partive sa i

përket dialogut duhet t'i tejkalojnë dallimet partiake sepse bëhet fjalë për nevojën e një pozicioni të qartë shtetëror, në një proces të vështirë. Andaj as LDK-ja e as LV-ja nuk e kanë luksin që çështja e dialogut ose kapriçot e njëjës a tjetrës parti ta pengojnë arritjen e marrëveshjes për koalicion dhe, rrjedhimisht, qëndrimin bashkues në dialogun me Serbinë", është shprehur Mushkolaj.

Pas përfundimi të zgjedhjeve të 6 tetorit grupet e ekspertëve të këtyre dy partive janë takuar


disa herë për t'i harmonizuar programet e tyre për bashkëqeverisje. Zyrtarët e këtyre partive kanë deklaruar se për çështjen e dialogut do të vendosin liderët e dy partive, Albin Kurti dhe Isa Mustafa. Këta të fundit kanë deklaruar se grupet e ekspertëve kanë harmonizuar rreth 80 për qind të programeve të tyre. LDK-ja ka këmbëngulur se marrëveshje për koalicion qeverisës nuk mund të bëjnë pa i certifikuar KQZ-ja rezultatet e zgjedhjeve të 6 tetorit.

## Në laparaskopi kryhet një ndërhyrje e komplikuar në veshkë

PRISHTINË, 13 NËNTOR (ER) - Një ekip i përbërë prej mjekëve kirurgë, urologë dhe anesteziologëve, në Klinikën e Kirurgjisë Abdominale, Shërbimi i Laparaskopisë, ka kryer një operacion të rrallë te një pacient, pas

ankesave për probleme në veshkë. Pacienti kishte dy cista, të shfaqura në të dy veshkat, të cilat janë larguar me laparaskop. "Ndërhyrjet me qasje laparoskopike e bëjnë më të lehtë punën, shkurtojnë kohëzgjatjen

dhe ofrojnë më shumë siguri gjatë intervenimit. Operacioni është kryer me sukses, ka zgjatur rreth një orë e gjysmë, ndërsa pacienti ka vazhduar trajtimin nën kujdesin e mjekëve përkatës", është thënë në njoftimin e QKUK-së.



Flet për "Epokën e re", Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport, Rexhep Hoti

# Programi Nacional për Rininë ka ma

## - Vetëm me arsim e kemi mundësinë e avancimit më të shpejtë dhe të mundshëm të shoqëritë e avancuara të planetit

Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport (KNKRS), Rexhep Hoti, ka bërë me dije se KNKRS-ja ka filluar përgatitjet për fillimin e garave të Kreativitetit Kulturor dhe Mendimit Kritik dhe Sportit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ai ka thënë se janë në fazën e zbatimit të këtyre garave nëpër të gjitha shkollat e vendit. Hoti ka theksuar se Programi Nacional për Rininë është programi i parë në përmasa të tilla që ka marrë mbështetjen e të gjithë spektrit politik të vendit si nga pozita, po ashtu edhe nga opozita. Ai ka mohuar zërat se hartimi i Programit Nacional është bërë pa konsultime paraprake me institucione përkatëse dhe pa përfshirjen e ekspertëve, psikologëve dhe pedagogëve. Hoti ka treguar se KNKRS-ja ka nënshkruar 40 marrëveshje, prej të cilave 29 janë marrëveshje bashkëpunimi me komunat e Kosovës, dy marrëveshje rajonale, një marrëveshje ndërkombëtare, gjashtë marrëveshje me universitete si dhe dy marrëveshje me kolegje



**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 13 NËNTOR -

"Epoka e re": Z. Hoti, duke i parë lajmet mbi aktivitetet tuaja nëpër shkolla, fitohet përshtypja se diçka është duke ndodhur nëpër shkollat në këtë kohë kur gjithçka duket të jetë në pritje të qeverisë Kurti? Hoti: Me fillimin e vitit të ri shkollor KNKRS-ja ka filluar edhe përgatitjet për fillimin e garave të Kreativitetit Kulturor dhe Mendimit Kritik dhe Sport dhe tash jemi në fazën e implementimit të këtyre garave nëpër të gjitha shkollat e vendit pa dallim. Natyrisht se koha e pritjes së një qeverie për ta dorëzuar mandatin dhe e tjetrës për ta pranuar atë shfaq vetvetiu vështirësi. Ato i hasim në përditshmërinë tonë, por përballë ngecjeve të tilla na duhet më shumë punë e aktivitete në terren.

"Epoka e re": A mund të na thoni më konkretisht çfarë është pozita juaj prej Koordinatorit dhe çfarë obligime dhe përgjegjësi keni në rrafshin praktik, pasi në këtë drejtim ende ka paqartësi të ndryshme në opinion apo gjete?

Hoti: Me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 07/63 dhe me aprovimin e Planit të Punës së Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport janë plotësuar Neni 47 dhe 48 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe Ligji për Arsimin Parauniversitar ku është e garantuar e drejta e fëmijëve për arsim dhe për t'i shfaqur talentet e tyre. Me një fjalë, e drejta për t'u arsimuar në mijëvjeçarën e tretë nënkupton drejtpërdrejt mundësinë e mësimnxënies dhe mundësinë e aktiviteteve dhe veprimtarive jashtëkurrikulare e kurrikulare për të gjithë nxënësit pa dallim. KNKRS-ja e plotëson boshllëkun e Neni 47 dhe 48 të Kushtetutës së Republikës duke ua ofruar mundësinë 316 mijë nxënësve të Republikës në aktivitete jashtëkurrikulare e kurrikulare që, në qoftë se shprehemi me fakte matematikore, krahas mësimnxënies, kap hiç më pak se 50 për qind të kohës së formimit të personalitetit të çdo nxënësi. KNKRS-ja e ka futur në zbatim parimin fundamental kushtetues që është gjithëpërfshirja e nxënësve pa dallim etnie, gjinie, gjuhësie, fetare a dallime të tjera.

"Epoka e re": A mund të na thoni cilat janë rezultatet e gjithëpërfshirjes së këtyre garave në nivel vendi.

Hoti: KNKRS-ja nga garat e përgjithshme në nivel shkolle, komune dhe republike të Garave Nacionale në Dituri dhe të Garave të Kreativitetit Kulturor e Mendim Kritik, prej 316 mijë nxënësve sa ka gjithsej në Republikën e Kosovës në nivelin fillor të mesëm të ulët dhe në nivelin e mesëm të lartë, janë shpallur 44 723 fitues nga 29 komuna pjesëmarrëse. Prej tyre në nivelin shkollor janë shpallur gjithsej 40 624 fitues. Të gjithë fituesit janë pajisur me certifikata qeveritare. Ndërsa në nivel të garave nëpër komuna në Kreativitet Kulturor dhe Mendim Kritik kemi 2 078 fitues, kurse në të Diturisë kemi gjithsej 1 467 fitues. Të gjithë fituesit do të pajisen me nga një set librash në vlerë prej 50 eurosh. Po ashtu, të gjithë nxënësit fitues të nivelit të Diturisë klasa e I-rë dhe e II-të do të pajisen me nga një set librash, pasi që gara për ta mbaron në këtë nivel për shkak të natyrës së garës e cila e ka ruajtur karakterin thelbësor të lojës në formësimin e saj. Të gjithë fituesit në nivel republike, që janë 554

fitues, kanë qenë nëpër kampe kreative në Malet e Sharrit dhe në Shqipëri për tri javë në tri grupe. Me në një fjalë, i bie se gati çdo i 6-ti nxënës në Republikën e Kosovës ka marrë një çmim në një garë të mbajtur nëpër shkolla.

"Epoka e re": A mund të na thoni se si dhe sa e kanë gjetur mbështetjen garat e Programit Nacional për Rininë?

Hoti: Nuk dua të flas për pjesën e detyrueshme institucionale të garave, që do të thotë se çdo institucion arsimor shkollor përkatës publik (tek arsimit privat jemi në rrjedhë të aplikimit) është i obliguar ta zbatojë atë. Por, dua ta them këtë: paramendojeni që në pjesëmarrjen e Garave të KKMK dhe të Diturisë prej të cilave kanë dalë 44 723 nxënës fitues, kanë marrë pjesë mijëra gra e burra të institucioneve tona arsimore, pjesa dërrmuese pa e marrë asnjë cent. Ky vullnet nuk ka ndodhur në asnjë kohë. Kjo e ka dëshmuar gjithëpërfshirjen në shkallë republike. Energjinë që kanë njerëzit për të investuar në arsim të fëmijët. Por institucionet qendrore, qeveria e ardhshme Kurti, ka detyrime shtesë për ta

realizuar këtë të drejtë kushtetuese dhe për ta funksionalizuar e standardizuar për kohë të ardhshme, me çka formësohet në tërësi edhe parimi i dytë fundamental i Programit Nacional për Rininë e që, krahas gjithëpërfshirjes, është edhe vijueshmëria.

"Epoka e re": Mos dëshironi të thoni se ju ende pa ardhur qeveria keni diçka për të kërkuar nga qeveria Kurti?

Hoti: KNKRS-ja i përgjigjet qeverisë dhe kryeministrit. Ata do ta shohin performancën e institucionit të KNKRS-së. Nga përvoja e terrenit janë evidentuar dy propozime konkrete që ndërlihen me aktivitetet dhe veprimtaritë e nxënësve dhe institucionet shkollore në tri fushat e mbajtjes së garave në KKMK, në Dituri dhe në Sport, e që i bie veprimtari e aktivitete për 948 mijë nxënës. Arsimiti është dielli, mendoj, më pas vijnë disa hapësira të zbrazura e pas tyre mund të vijnë liria, zhvillimi ekonomik, demokracia e çka jo tjetër. Vetëm me arsim e kemi mundësinë e avancimit më të shpejtë dhe të mundshëm të shoqëritë e avancuara të planetit. Kjo nuk i kushton shumë buxhetit

# rrë mbështetjen e spektrit politik

programin e parë që garanton bashkimin kombëtar për nxënës dhe studentë. Çka do të thotë se KNKRS në qeverinë Haradinaj e ka miratuar mundësinë e bashkëpunimit bilateral të Programit (Kosova me cilindo shtet fqinj apo rajonal), multilateral (Kosova me disa shtete fqinje a rajonale njëherësh) dhe mbarëkombëtar (Kosova, brenda së cilës marrin pjesë edhe Lugina e Preshevës, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia dhe Diaspora). Madje, në këtë drejtim KNKRS-ja ka shkuar edhe më larg. Zyra e KNKRS ka hartuar edhe Draftprogramin Nacional për Rininë, me gjithë draftbuxhetet e kalkuluar për të gjithë nxënësit dhe studentët e Republikës së Shqipërisë dhe këtë Program ia kemi dorëzuar personalisht kryeministrit Rama dhe ministres së Arsimit të tij, me insistimin e vet kryeministrit të Shqipërisë. E kemi hartuar edhe Draftprogramin Nacional për Rininë për Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe për Malin e Zi për të gjithë nxënësit dhe studentët e tyre me pjesë të draftit edhe për buxhet. Këtë e kemi bërë nga vullneti për të dëshmuar se gara mbarëkombëtare nuk është një dashuri, përkushtim dhe ideal i yni që i përjashton garat bilaterale apo multilaterale me shtetet e tjera. Përkundrazi. Kjo e rrit dashurinë dhe respektin për veten tonë në radhë të parë. Një dhuratë më të madhe nuk kam mundur t'ia përgatis idealit që ka z. Kurti nga ajo që kam kuptuar tash e disa dekada prej tij.

zotin Kurti për të biseduar për programin Nacional për Rininë. Z. Kurti, sikurse edhe z. Mustafa, janë informuar personalisht nëpërmjet njerëzve të tyre për gjithë Programin dhe për të gjithë udhëzuesit. Po ashtu, janë informuar 120 deputetë. Me z. Kurti, sa më kujtohet, kam pasur krejt dy takime, njëri në një debat televiziv në vitin 2004 dhe një takim për kafe para 5 apo 6 vjetësh.

**"Epoka e re":** *Ka pasur zëra se hartimi i Programit Nacional është bërë pa konsultime paraprake me institucione përkatëse dhe pa përfshirjen e ekspertëve, psikologëve, pedagogëve etj. Çka mund të na thonin në këtë drejtim?*

Hoti: Para aprovimit në qeveri, Programi Nacional për Rininë u është nënshtruar procedurave të nevojshme si dhe ka qenë në platformën për konsultime publike. Zyra e KNKRS ka hartuar 17 udhëzues për mbajtjen e garave në bashkëpunim me grupet punuese me ekspertë të fushave përkatëse, ku në përbërje ka pasur profesorë universitarë, pedagogë, psikologë, përfaqësues të federatave sportive, mësimdhënës, anëtarë të shoqërisë civile, drejtorë shkollash, përfaqësues të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë. Për më shumë, këto dy ministri me vendim kanë caktuar nga një zëvendësministër që të merren ekskluzivisht me Programin Nacional për Rininë. Gjatë gjithë kohës, për aktivitetet e zyrës së KNKRS-së, mbi 23 e-maile i janë dërguar edhe Komisionit Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, si njoftime

për rrjedhën e zbatimit të Programit.

**"Epoka e re":** *A e ka pasur mbështetjen e opozitës së kaluar Programi Nacional për Rininë?*

Hoti: Programi Nacional për Rininë është programi i parë në përmasa të tilla që ka marrë mbështetjen e gjithë spektrit politik të vendit si nga pozita, po ashtu edhe nga opozita. Është program që është mbështetur dhe është nënshkruar për thellim të bashkëpunimit nga të gjithë përfaqësuesit e partive politike në pushtet dhe opozitë e që janë të përfaqësuara në krye të institucioneve të pushteteve lokale, si nga Vetëvendosje, LDK, PDK, AAK, Nisma, PSD. Po ashtu, marrëveshje janë nënshkruar edhe me kryetarë komunash nga komunitetet si Komuna e Mamushës si dhe Komuna e Novobërdës nga kryetari i saj i komunitetit serb. Veç shtrirjes në Kosovë, në nivelin rajonal Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport ka marrëveshje bashkëpunimi me Komunën e Preshevës dhe Bujanocit. Në kuadër të zbatimit të programit, KNKRS ka nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare të bashkëpunimit me Unionin Evropian të Shahut. Në total, KNKRS ka nënshkruar 40 marrëveshje, prej të cilave 29 janë marrëveshje bashkëpunimi me komunat e Kosovës, dy marrëveshje rajonale, një marrëveshje ndërkombëtare, gjashtë marrëveshje me universitete si dhe dy marrëveshje me kolegje.

**"Epoka e re":** *Nuk na thatë cilat janë dy propozimet që do t'ia bëni z. Kurti dhe qeverisë së tij?*

Hoti: Konsideratë për punën tuaj dhe për pyetjen që më bëni, por këtë më duhet ta adresoj së pari tek i zoti i shtëpisë.

dhe kjo nuk do të thotë mospërfillje të agjendave të tjera. Përkundrazi. Do të thotë arsimim dhe edukim për to.

**"Epoka e re":** *A keni bregë se kryeministri në ardhje, Kurti,*

*edhe mund t'ju largojë?*

Hoti: Nuk kam bregë. Me rëndësi është Programi Nacional për Rininë që është ekskluziv për nxënësin dhe studentin. Z. Kurti dhe qeveria e tij e ka të miratuar

**"Epoka e re":** *A jeni takuar me z. Kurti personalisht për të biseduar për këto gjëra?*

Hoti: Jo, nuk jam takuar kurrë me

## Fillon procesi i rinumërimit të 1 428 vendvotimeve në QNR

PRISHTINË, 13 NËNTOR- Ka filluar procesi i rinumërimit pas vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP).

Zëdhënësi i Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), Valmir Elezi, ka thënë se për këtë kanë shtuar edhe kapacitetet. "Pasi e kemi marrë vendimin e PZAP-zë dhe pasi kemi parë me vëmendje listën e vendvotimeve që duhet të rinumërohen, mund t'ju them se janë 1 mijë e 428 vendvotime që do të rinumërohen gjatë ditëve në vazhdim. Pra, nga lista e PZAP-së 30 vendvotime ishin

të shënuara nga dy herë dhe 12 vendvotime të tjera janë rinumëruar më parë në QNR me vendim të KQZ-së", ka thënë ai.

Qendra e Numërimit dhe Rezultateve do të punojë në dy ndërrime si dhe është shtuar numri i tavolinave apo njësive të numërimit nga 23 në 32. Kjo sipas Elezit është bërë në mënyrë që të arrihet sa më shpejt të përmbyllin të gjithë këtë proces. Për të vëzhguar procesin e rinumërimit janë njoftuar edhe subjektet politike, të cilat mund të dërgojnë nga një vëzhgues për secilën njësi numërim.



# Formimi i Kuvendit dhe qeverisë së re nuk ndikohet nga ankesat në Kushtetuese

Prishtinë, 13 nëntor - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund ta certifikojë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve parlamentare të mbajtura më 6 tetor, pa pasur nevojë ta presë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, në rast se në këtë instancë subjektet politike dërgojnë ndonjë ankesë, thonë njohës të çështjeve juridike kushtetuese. Pas përfundimit të procedurave dhe rinumërimit të votave, sipas vendimeve të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia dhe Gjykatës Supreme, me certifikimin e rezultateve mund të fillojë konstituimi i institucioneve të reja, thonë ekspertët. Aktualisht, ankesat e subjekteve politike kanë mbërritur vetëm në instancat e Panelit Zgjedhor për Ankesa e Parashtrësia dhe Gjykatës Supreme.

Ndërkaq koalicioni Nisma Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë kishte paralajmëruar se do t'i drejtohej edhe Gjykatës Kushtetuese nëse kërkesat e këtij koalicioni nuk trajtohen drejt nga dy instancat e para.

Profesori i çështjeve juridike kushtetuese, Mazllum Baraliu, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se rezultati përfundimtar nuk ka nevojë të presë ndonjë ankesë apo vendim eventual të Gjykatës Kushtetuese. "Sa iu përket ankesave, përkitazi me procesin elektoral zgjedhor të 6 tetorit deri në Gjykatën Supreme shkojnë ato. Dhe pasi të përfundojnë ato (ankesat), absorbohen, trajtohen,

pranohen ose refuzohen dhe kalojnë afatet e caktuara, atëherë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është i detyruar ta bëjë certifikimin e rezultatit dhe nuk është i detyruar të presë ndonjë parashtrësë se si do të përfundojë lënda në Gjykatën Kushtetuese", ka thënë Baraliu, duke shtuar se: "Sa i përket procesit ankimor, nga KQZ-ja në PZAP dhe nga PZAP-ja në Gjykatën Supreme, aty përfundohet procedura administrative e trajtimit të çështjeve elektorale dhe ankimeve elektorale. Pra, nuk ka ndikim nëse çështja vazhdohet sa i përket certifikimit të rezultateve dhe konstituimit të organeve, qoftë atyre legislative, qoftë atyre ekzekutive në Republikën e Kosovës", ka theksuar Baraliu.

Ai rikujton se në zgjedhjet e fundit lokale të mbajtura në vitin 2017 ka pasur një ankesë në Gjykatën Kushtetuese, por deri në epilogun përfundimtar të gjykatës institucionet e reja janë formuar. Baraliu rikujton rastin e zgjedhjeve për kryetar të Prishtinës në garën në mes të Arban Abrashit të Lidhjes Demokratike dhe Shpend Ahmetit, atëherë kandidat i Lëvizjes Vetëvendosje, kurse aktualisht kryetar i Partisë Socialdemokrate, lëndë kjo që kishte zgjatur me muaj në Kushtetuese, por ndërkohë kishte vazhduar procedura e konstituimit të organeve lokale.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shpallur tashmë rezultatin



përfundimtar të zgjedhjeve të mbajtura më 6 tetor. Rezultati u shpall më 7 nëntor, por ai nuk është certifikuar ende pasi që tani duhet të pritët edhe faza e ankesave dhe shqyrtimeve të tyre. Pas ankesave të disa subjekteve politike, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ka vendosur ta bëjë anulimin e votave nga Serbia dhe njëherësh të rinumërohen 1 472 vendvotime. Nga Lëvizja Vetëvendosje është bërë me dije se tre deputetë të LV-së kanë bërë ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit të PZAP-së, pa e specifikuar se për cilin vendim të PZAP-it bëhet fjalë.

Gjykata Supreme ka kohë 72 orë për të vendosur për ankesat eventuale.

Valmir Elezi, zëdhënës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, thotë se procesi i rinumërimit të votave do të fillojë të mërkurën. "KQZ-ja ka marrë konfirmimin nga institucioni përkatës se nuk ka ndonjë ankesë që është paraqitur lidhur me vendimin e PZAP-it, që e urdhëron KQZ-në ta bëjë rinumërimin e rreth 1 500 vendvotimeve", ka thënë Elezi.

Në bazë të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Lëvizja Vetëvendosje ka fituar më

së shumti vota, pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës, koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Partia Socialdemokrate e kështu me radhë. Çështje për diskutim mbetet nëse koalicioni Nisma Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë e kalon pragun prej pesë përlindësh, për të fituar ulëse gjatë mandatit të ardhshëm të Kuvendit të Kosovës.

Nga komunitetet pakicë, Lista Serbe ka fituar 10 ulëset e garantuara për komunitetin serb, kurse 10 ulëse të tjera të garantuara u janë ndarë komuniteteve joserbe.



## Niveli i ujit në liqenin e Batllavës është 8.50 metra nën kuotën maksimale

PRISHTINË, 13 NËNTOR (ER) - Kryeshefi ekzekutiv i Kompanisë së Ujësjellësit Rajonal "Prishtina", Ilir Abdullahu, ka thënë se niveli i ujit në liqenin e Batllavës është 8.50 metra nën kuotën maksimale. Ai në llogarinë e vet në

"Facebook" ka shkruar se niveli i ujit në liqenin e Badocit është 8.8 metra nën kuotën maksimale. "Shpenzimi racional i ujit të pijshëm në këtë periudhë është i domosdoshëm", ka thënë Abdullahu.



## Përfundon projekti i vendosjes së kamerave të sigurisë në Suharekë

Suharekë, 13 nëntor (ER) - Në kuadër të Drejtorisë për Administratë në Komunën e Suharekës, ka përfunduar projekti i vendosjes së kamerave të sigurisë në qytet. Ky projekt do t'u shërbejë të gjithë qytetarëve të

Komunës së Suharekës, në veçanti të Drejtorisë për Administratë në Komunën e Suharekës, ka përfunduar projekti i vendosjes së kamerave të sigurisë në qytet. Ky projekt do t'u shërbejë të gjithë qytetarëve të

# Sot i jepet lamtumira e fundit regjisores Arzana Kraja



Në mëngjesin e së mërkurës në Prishtinë ka vdekur regjisorja Arzana Kraja, vajza e kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Mehmet Kraja. Varrimi i së ndjerës do të bëhet sot, në orën 14:00, në varrezat e Arbërisë (ish-Dragodanit) në Prishtinë. Ngushëllime familjes Kraja i kanë shprehur përfaqësues të institucioneve të vendit, të shoqërisë civile dhe të komunitetit artistik në Kosovë, të cilët kanë vlerësuar se angazhimi i Arzanës në fushën e kinematografisë ishte i jashtëzakonshëm

**EPOKA  
ERE**

**Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 13 NËNTOR** - Vajza e kryetarit të Akademisë së Shkencave të Arteve të Kosovës, Mehmet Kraja, regjisorja Arzana Kraja, ka vdekur të mërkurën në mëngjes. "Më datë 13.11.2019, rreth orës 09:08, policia ka marrë një informatë për një trup të pajetë në lagjen 'Kalabria' në Prishtinë. Njësitë policore kanë dalë menjëherë në vendin e ngjarjes, përfshirë edhe ekipin mjekësor të emergjencës, të cilët kanë konstatuar vdekjen e personit të gjinisë femërore", thuhet në njoftimin e PK-së.

Arzana Kraja njihet për filmat "Shkurta" dhe "Fusha e mëllenjave".

Motra e Arzanës, Gresa Kraja, ka bërë me dije se sot (e enjte) në orën 14:00 do të bëhet varrimi i së ndjerës. "Me pikëllim dhe zemër të thyer ju njoftojmë për ndarjen nga jeta të vajzës dhe motrës sonë të dashur Arzana Kraja. Varrimi i saj bëhet të enjten te varrezat e Dragodanit në Prishtinë në orën

14:00. Dyert e familjes do të jenë të hapura në lagjen 'Ulpiana D9', pranë klinikës 'Fati im', ka njoftuar Gresa nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook".

Ngushëllime familjes Kraja i kanë shprehur përfaqësues të institucioneve të vendit, shoqërisë civile dhe komuniteti artistik në Kosovë. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se Arzana ka kontribuar shumë në kinematografinë e Kosovës. "Vdekja e regjisores Arzana Kraja është lajm i trishtuar për të gjithë ne. Ajo i dha shumë kinematografisë sonë me talentin e saj dhe ishte shumë e re për t'u ndarë nga jeta. Ngushëllime familjes Kraja, miqve të Arzanës dhe gjithë komunitetit artistik dhe kulturor në vendin tonë", është shprehur presidenti në një postim në llogarinë e vet në "Facebook".

Në të njëjtën platformë, kryeministri në largim i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka shprehur ngushëllime për ata që kanë njohur regjisoren Kraja. "I prekur thellë nga ndarja e parakohshme nga jeta e Arzana Krajës. Pata nderin ta

njihja personalisht. Arzana me artin e saj i dha shumë Kosovës. Ngushëllime të sinqerta familjes, miqve dhe komunitetit të artit. Prehu e qetë, Arzana!", ka shkruar Haradinaj.

Ngushëllime për vdekjen e Arzana Krajës ka shprehur edhe kryetari i Kuvendit në detyrë, njëherësh kryetar i PDK-së, Kadri Veseli. Ai ka thënë se regjisorja Kraja la gjurmë në artin tonë kinematografik dhe do të kujtohet nga të gjithë për arritjet e saj. "Lajm shumë i dhimbshëm vdekja e regjisores Arzana Kraja. Ajo la gjurmë në artin tonë kinematografik dhe do të kujtohet nga të gjithë për arritjet e saj. Ngushëllime familjes, të afërmeve dhe mbarë komunitetit të artistëve për këtë humbje", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe ministri në detyrë i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, i ka dërguar një telegram ngushëllimi familjes Kraja me rastin e vdekjes së regjisores Arzana Kraja. Në këtë telegram ngushëllimi është thënë se vdekja e Arzanës është humbje

e madhe për kulturën e shtetit tonë. "Ndarja e hershme e Arzana Krajës është humbje e rëndë jo vetëm për ju, familjen dhe miqtë, por është humbje dhe do të jetë mungesë e madhe për artdashësit dhe kulturën e Kosovës", është thënë në telegramin e ngushëllimit të ministrit Gashi.

Edhe Qendra Kinematografike e Kosovës nëpërmjet një postimi në rrjetin social "Facebook" ka theksuar se angazhimi i regjisores Kraja në fushën kinematografisë ishte i jashtëzakonshëm. "Jemi të

shokuar nga lajmi për vdekjen e regjisores Arzana Kraja. Angazhimi i saj në fushën e kinematografisë ishte i jashtëzakonshëm. Ngushëllime familjes, miqve dhe të gjithë bashkëpunëtorëve!", është thënë në njoftim. Ndërkaq Teatri Kombëtar i Kosovës (TKK) nëpërmjet një njoftimi për media ka bërë me dije se pas vdekjes së regjisores Arzana Kraja, në shenjë respekti ndaj familjes dhe komunitetit artistik, ka anuluar shfaqjet e parapara për të mërkurën.

## AshAK-u ngushëllon Mehmet Krajën për humbjen e së bijës

Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës (AshAK) ka dërguar telegram ngushëllimi me rastin e vdekjes së bijës së akademik Mehmet Krajës, Arzanës. Në telegram thuhet se vdekja e papritur e Arzanës ka tronditur gjithë kolektivin e AshAK-ut. "Vdekja e papritur e bijës suaj ka tronditur thellë gjithë kolektivin e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Është kjo dhembje e madhe për ju dhe familjen, për miqtë dhe dashamirët tuaj dhe për të gjithë ata që e kanë njohur dhe e kanë dashur Arzana Krajën, regjisore e skenariste filmi, artiste e shquar dhe e

dëshmuar me vepra të vlerësuar lart", thuhet në telegramin e ngushëllimit. Ky telegram ngushëllimi është dërguar nga nënkryetari i AshAK-ut, akademik Jusuf Bajraktari. "Duke qenë me ju dhe pranë jush në këto çaste tejet të hidhura, duke bashkëndierë për humbjen e madhe që ju ka gjetur, ju lutem, në emër të të gjithë anëtarëve të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, të stafit drejtues e të administratës, si dhe në emrin tim personal, pranoni ngushëllimet tona më të sinqerta", përfundon telegrami ngushëllues.

Ekspertiza zvicerane dhe vrasja e Astrit Deharit

# Kush e fshehu jastëkun me jargë që ishte në dhomën e krimit?

Shkruan: Bardhyl  
MAHMUTI



Me pretendimin se është mbështetur në rezultatet e autopsisë së ekipit mjeko-ligjor të Institutit të Mjekësisë Ligjore të Kosovës dhe në rezultate të hulumtimeve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Sylë Hoxha, e cilësoi vdekjen e Astrit Deharit si "pasojë të asfiksionit mekanike nga dëmtimet e vetëshkaktuara".

Ky konstatim u hodh poshtë nga ekspertët zviceranë të cilët erdhën në përfundim se Astrit Dehari jo vetëm që nuk ka bërë vetëvrasje, por objektivisht as që e ka pasur të mundur t'ia zinte frymën vetes me një shishe plastike të rrumbullakët dhe pa kënde e me skaje të lëmuara, baza e së cilës kishte diametër 6 cm. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me çështje të vullnetit nëse Astrit Dehari dëshironte apo nuk dëshironte të vendoste një shishe të tillë në rrugët e frymëmarrjes dhe të mbante të bllokuara këto rrugë. Këtu kemi të bëjmë me pamundësi objektive: Në aspektin fiziologjik, bllokimi i rrugëve të frymëmarrjes do ta bënte ndërprerjen e furnizimit të organizmit me oksigjen dhe kjo do të shkaktohte humbje të vetëdijes dhe të aftësisë së muskujve të duarve për ta mbajtur shishen në rrugët e frymëmarrjes. Këtë çështje të shkencës së mjekësisë, që lidhet me vetitë dhe funksionimin e organeve të qenieve të gjalla, e di çdo student i ciklit të parë të studimeve të mjekësisë që ka dhënë provimin e fiziologjisë. Kam bindjen e plotë, se këtë fakt të shkencës së fiziologjisë e kanë ditur edhe anëtarët e ekipit mjeko-ligjor që kanë bërë raportin e autopsisë së Astrit Deharit. Është çështje tjetër pse, në rastin konkret, ky fakt është lënë në heshtje dhe nuk është thënë në mënyrë të prerë, se Astrit Dehari nuk ka pasur asnjë mundësi t'ia zinte frymën vetes me atë shishe plastike.

Përveç këtij fakti, ekspertiza zvicerane nxjerr në shesh lëshimet e mëdha që janë bërë gjatë autopsisë së Astrit Deharit. Aspekte të ndryshme të dobësive dhe shtrembërimeve që përmban raportin e autopsisë i Institutit të Mjekësisë Ligjore të Kosovës janë përmendur në shkrimet e mia paraprake për këtë temë. Në shkrimin e sotëm po kufizohem vetëm në atë që ka të bëjë me lëndimet në gojë, për të cilat pretendohet të jenë shkaktuar nga shishja plastike.

Kur bëhet përshkrimi i dëmtimeve të brendshme që i ishin shkaktuar Astrit Deharit, në pikën

6 të raportit të lartpërmendur të autopsisë thuhet: "Në rrënjën e gjuhës, paralelisht në të dy anët e saj, rreth 6.5 cm nga maja e gjuhës ndodhen shqyerje paralele identike, me buzë të çrregullta të përmasave: në anën e djathtë 15x10mm me thellësi 4mm, kurse në anën e majtë: 15x8mm me thellësi 6mm. Këto dy dëmtime paralele më me besueshmëri janë të shkaktuara nga veprimi mekanik i një mjeti me konsistence solide (të fortë), i cili duke mbyllur zgavrën e gojës në thellësi, ka hasur në rezistencë në qiellzën e fortë, ndërsa në vendin me rezistence më të vogël, që është gjuha, ka shkaktuar shqyerje paralele në të dy anët".

Konstatimet e tilla hidhen poshtë nga ekipi mjeko-ligjor zviceran. Në ekspertizën zvicerane saktësohet se "shqyerjet e rrënjës së gjuhës dhe i skajit të djathtë të gjuhës janë pasojë e veprimeve të shkaktuara nga një send i mprehtë ose një send që shpon dhe që pret". (Të mos harrojmë se shishja plastike ishte me skaje të lëmuara, e rrumbullakët dhe pa kënde). "Mungesa e depërtimeve hemorragjike në periferi dëshmon për lëndime të shkaktuara në periudhën pas vdekjes. Nga vendi ku ndodhen dhe nga simetria e plagëve, sipas të gjitha gjasave ato janë shkaktuar nga nxjerrja e gjuhës gjatë autopsisë. Për ilustrim, i njëjti lloj lëndimi shihet në një pjesë të autopsisë së gjuhës, të publikuar në literaturë (Kurihara dhe autorë të tjerë, 1992). Disa çarje që lidhen me nxjerrjen e gjuhës dhe të faringut në lartësinë e qiellzës janë të një aspekti të ngjashëm dhe shihen në videot dhe fotografite të autopsisë. Hipoteza e propozuar nga mjekët ligjorë, se çarjet janë shkaktuar nga presioni mbi gjuhë, pas mbylljes së tërësishme të pjesës së thellë të gojës (qiellzës së fortë) me një send të fortë, nuk na duket e mundur, për arsye të mungesës së shenjave të vitalitetit përreth lëndimeve, si dhe për shkak të morfologjisë së këtyre lëndimeve. Përmendje, në literaturën mjeko-ligjore nuk kemi gjetur gjurmë të një mekanizmi të tillë".

Përveç pasaktësive të lartpërmendura të ekipit mjeko-ligjor të

Kosovës, ekspertiza zvicerane thekson edhe lëndimet në gjuhë dhe në qiellzë, të cilat nuk janë përmendur fare nga ekipi mjeko-ligjor i Kosovës. Bëhet fjalë për "një çarje sipërfaqësore në skajit anësor të pjesës së djathtë të gjuhës, që ndodhet përpara shqyerjes së përshkruar në raportin e autopsisë" dhe "njolla të kuqe në vjollcë në mukozën e rafemedianës (term mjekësor, që përkufizon vijën që ndan mes për mes qiellzën e butë) të qiellzës së butë dhe të pjesës së pasme paramediane të djathtë të qiellzës së butë, që paraqet zona të depërtimeve hemorragjike", të cilat shihen edhe nga ekzaminimi i jashtëm, por që nuk i paskan parë "ekspertët" e Kosovës!

Sipas ekspertizës zvicerane, "këto lëndime janë rezultat i goditjeve me sende të forta, jo të mprehta, dhe mund të kenë ardhur nga goditja e pjesës së poshtme (baza e shishes) të shishes plastike në mukozë".

Përveç dallimeve rreth plagëve të shkaktuara në gojë, ekipi mjeko-ligjor zviceran nuk pajtohet me konstatimet e autopsisë rreth sendeve që janë përdorur për t'ia zënë frymën Astrit Deharit. Sipas autopsisë, "vdekja e Astrit Deharit ka ardhur si pasojë e asfiksionit mekanike nga bllokimi i rrugëve të sipërme të frymëmarrjes nga një mjet me konsistencë solide (i fortë)".

Në konkluzionet e ekspertizës zvicerane theksohet se "vdekja e z. Astrit Dehari është rezultat i asfiksionit dhe më e besueshme është që kjo të jetë bërë nëpërmjet zënies së frymës të llojit 'smothering'". Ndërkaq, sa i përket mënyrës se si është realizuar zënia e frymës në rastin konkret, ata kanë divergjencë më të mëdha me ekipin mjeko-ligjor të Kosovës.

Për ekipin mjeko-ligjor të Kosovës, "bllokimi i rrugëve të sipërme të frymëmarrjes është bërë nga një mjet me konsistencë solide (i fortë)", pra nga shishja plastike. Rreth kësaj çështjeje, ekspertiza zvicerane vjen te një konkluzion tjetër: "Sendi i gjetur në gojë (shishja e mjalit), mund të jetë përdorur për të mbyllur rrugët e frymëmarrjes së z. Astrit Deharit". Por në analizën e tyre ata shpjegojnë në mënyrë bindëse se shishja

plastike nuk ka mundur të mbyllte tërësisht rrugët e frymëmarrjes.

"Në rastin e z. Dehari, shishja është gjetur e futur në gojë nga baza e saj, diametri i së cilës është 6cm. Matjet anatomike të laringut të kryera nga grup autorësh (EckelHe, Sittel C., Zorowka P dhe Jerke A. dhe të prezantuara në veprën "Dimensions of the laryngeal framework in adults", 1994) mundësojnë të vlerësohet se diametri normal i vrimës së laringut te njeriu është mesatarisht 3,82cm (minimum 27mm dhe maksimumi 63mm). Në propozimin që kjo matje bazohet në distancën ndërmjet strukturave kërcore, që kufizojnë vrimën e laringut (briiri i sipërm i kërcit të tiroides), të dhënat janë mbivlerësuar, sepse ato nuk përfshijnë indet e buta, të cilat mbulojnë strukturat kërcore. Pra, baza e shishes plastike do të duhej të gjendej mbi epiglotë. Një argument tjetër që shkon në drejtim të këtij konstatimi, është prania e madhe e materieve ushqimore në bronke. Në të vërtetë, që të ndodhë një thithje e tillë e materialeve ushqimore nga bronket, është e nevojshme që hapësira ndërmjet mureve të laringut të jetë e lirë".

Rrjedhimisht, ky është një fakt objektiv, që dëshmon se shishja plastike nuk ka mundur t'ia zinte frymën tërësisht. Përveç këtij fakti, janë edhe deklaratat e përmendura në shkrimin paraprak, që dëshmojnë se Astrit Dehari kishte pasur puls dhe kishte marrë frymë, në kohën kur është zbuluar me shishen plastike në gojë. Fakte të tjera, në të cilat mbështetet ekipi mjeko-ligjor zviceran për të argumentuar pohimin se, përveç shishes plastike, në zënie e frymës Astrit Deharit kanë mundur të përdoren edhe mekanizma të tjerë janë lëndimet në pjesën e sipërme të ballit, në pjesën e poshtme të anës së djathtë të fytyrës, në pjesën e djathtë anësore të qafës, në parakrahun e djathtë dhe në shuplakën e dorës së djathtë, të cilat nuk janë lëndime sipërfaqësore, por pllaka pergamene, që shprehin lëndime të brendshme të indeve ose të organeve nga goditja me sende të forta. Këto lëndime vërtet nuk mund të shpjegohen nëpërmjet një veprimi vetëvrasës me sende të mprehta dhe me zënie fryme. Hipoteza e lëndimeve të shkaktuara nga bartja e trupit, nga tërësia e veprimeve për ta ringjallur dhe nga shtrëngimet e rastësishme nuk e shpjegojnë tërësinë e këtyre konstatimeve dhe nuk duket plotësisht bindëse. Nga ana tjetër, këto ekimoza (mavijosje) vërehen në vendet karakteristike për lëndimet, që janë shkaktuar gjatë kapjes me duar në qafë, të llojit

"çelësi i krahut", ose formave të tjera të dhunës në qafë. Për shkak të këtij fakti, një mekanizëm i tillë i lëndimit nuk mund të përjashtohet dhe duhet të përmendet".

Nga tërësia e lëndimeve të lartpërmendura, dhuna e shkaktuar në qafë është shenjë e pakontestueshme e përdorimit edhe të një mekanizmi tjetër për të penguar rrugët e frymëmarrjes së Astrit Deharit.

Ekipi mjeko-ligjor zviceran erdhe te këto konkluzione në bazë të materialeve që u janë dërguar nga ata që kanë dosjen e plotë të rastit "Astrit Dehari".

Megjithatë, një element shumë i rëndësishëm i skenës së krimit nuk i është dërguar Njësisë Romande të Mjekësisë Forenzike të Qendrës Universitare Ramande të mjekësisë ligjore në Lozanë të Zvicrës: Jastëku me mbetje jargësh që u gjet në dysheme, në dhomën e krimit!

Në faqen 16 të raportit të 14 qershorit 2019 përshkruhet lista e gjërave që i janë vënë në dispozicion ekipit mjeko-ligjor të Zvicrës. Në këtë listë mungon jastëku me jargë, që është gjetur në tokë, në një dhomë ku ka pasur një të vdekur nga zënia e frymës!!! Nuk ka asnjë dyshim, se ky element do të shërbente për shtrimin e hipotezës edhe për një mekanizëm të tretë të përdorur në vrasjen me zënie fryme të Astrit Deharit. Sidoqoftë, ky jastëku mund të mbajë edhe gjurmët e ADN-së, të vlefshme për të ndriçuar krimin.

Duke parë sesi dikush është përpjekur të fshehtë gjurmët e krimit, ajo që shtrohet publikisht në këtë kontekst ka të bëjë me dilemën që kam, nëse ka mbetur i padëmtuar ky jastëku (në kuptimin e gjurmëve gjenetike) dhe nëse ende është në materialelet e dosjes së Astrit Deharit.

Nëse vërtet jastëku ka mbijetuar në përpjekjen për fshehjen e krimit dhe nëse nga ai nuk janë zhdukur gjurmët gjenetike, kam bindjen e plotë se analiza e hollësishme e kësaj prove materiale do të ndriçojë, ndër të tjera, nëse vërtet shishja plastike në gojë e Astrit Deharit të shtirë, me krahë të hapur, siç e përshkruajnë dëshmitarët, ka qenë njëri nga mekanizmat e bllokimit të rrugëve të frymëmarrjes, apo është shfrytëzuar si mjet për të fshehur mekanizmat e tjerë të kësaj vrasjeje kaq të shëmtuar dhe çnjerëzore.

Mendoj se me serinë e shkrimeve lidhur me manipulimet që i bëjnë ekspertizës zvicerane për rastin "Astrit Dehari" kam kryer obligimin tim si qytetar i Kosovës dhe si politolog. Ekspertizës zvicerane do t'i referohem edhe në shkrimet që do të bëj në të ardhmen, deri në ngadhënjimin e plotë të drejtësisë për Astritin.



## Subvencionet për efijencë të energjisë në Kosovë kapin shifrën 20.6 milionë dollarë

EPOKA  
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Fondacioni i Mileniumit i Kosovës (MFK), si entitet zbatues i marrëveshjes 49 milionë dollarësh të Pragut, të nënshkruar në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Agjencisë Federale Amerikane (MCC), ka lansuar projektin 20.6 milionë dollarë, të quajtur Subvencionet për Efijencë të Energjisë në Kosovë (SEEK), që do të zbatohet nga konsorciumi gjerman GFA dhe HPC.

Udhëheqësja e projektit të Grave në Energji në SEEK, Janna Fortmann, ka vlerësuar lansimin e SEEK-ut si ditë të madhe për gratë ndërmarrëse. Kurse mospjesëmarrja e mjaftueshme e grave në ndërmarrësi u cilësua si problem botëror nga Fortmann. "T'i fuqizojmë dhe mbështesim gratë në ndërmarrësi do të thotë t'i ndihmojmë familjet dhe ambientin biznesor, andaj përmes SEEK-ut do t'i shtyjmë gratë t'i marrin vendimet e tyre mbi investimet



në efijencën e energjisë, që çojnë në biznese të qëndrueshme", u shpreh ajo. Folës kryesor në lansimin e SEEK-ut ishte Petrit Selimi, drej-

tor ekzekutiv i MFK-së, i cili ka shpjeguar më hollësisht qëllimin e projektit SEEK, duke vënë në pah faktin se 2 600 shtëpi dhe banesa kosovare do të përfitojnë

nga masat e efijencës. Administratori i USAID-it, Mark Green, ka ritheksuar përkushtimin e USAID-it për bashkëpunim dhe përpjekje drejt zhvillimit ekonomik të Kosovës.

SEEK-u synon të ofrojë stimuj financiarë dhe teknikë për sektorin rezidencial që mundëson investime në masat e efijencës së energjisë si dhe t'i mbështesë gratë ndërmarrëse në energji dhe sektorë të tjerë.

Fokusi parësor teknik i ndërhyrjeve të SEEK-ut janë masat e efijencës së energjisë që do ta zvogëlojnë konsumin e energjisë elektrike për ngrohje dhe promovojnë përdorimin e pajisjeve të ngrohjes me efijencë të energjisë, si dhe stimujt që synojnë rritjen e përfshirjes së grave në mundësitë e biznesit të sektorit energjetik dhe investimet e efijencës për bizneset në pronësi të grave.

## KDI-ja: Ministria e Infrastrukturës që 12 vjet nuk po i përfundon punimet në dy rrugë nacionale



PRISHTINË, 13 NËNTOR (ER) - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur të mërkurën tryezë diskutimi gjatë së cilës është publikuar hulumtimi "Rrugë pa fund" që shpërfaq gjetjet e KDI-së nga monitorimi i prokurimit publik, me theks të veçantë menaxhimit të kontratave, në Ministrinë e Infrastrukturës, për dy projekte të mëdha siç janë: zgjerimi i rrugës Prishtinë - Pejë dhe rrugës Prishtinë - Mitrovicë.

Fjolla Uka Haxhaj, hulumtuuese nga KDI-ja, gjatë prezantimit të gjetjeve të këtij hulumtimi ka theksuar se janë analizuar arsyet që kanë ndikuar në vonesat e përfundimit të këtyre dy projekteve. "Këto dy projekte kanë filluar në vitin 2007, respektivisht 2009. Tashmë janë bërë 12 vjet që nuk kanë përfunduar, ndërsa

qytetarët nuk kanë informacion se kur pritet të finalizohen edhe mbi 50 km rrugë të papërfunduara nga të dy projektet", ka theksuar ajo. Sipas saj, shkaku kryesor, për stërzgjatjen e punimeve në këto dy rrugë, ka qenë procesi i shpronësimit, pasi që Ministria e Infrastrukturës ka filluar punët ndërtimore pa përfunduar shpronësimi. Pronarët e pronave të shpronësuara për arsye të ndryshme kanë refuzuar t'i lejojnë punimet pa përfunduar kompensimi nga shpronësimi. Si rrjedhojë e gjithë kësaj edhe përfundimi i punimeve nuk ka ndodhur në kohën e paraparë. Sipas të dhënave të KDI-së, ekziston vetëm një rast kur Ministria e Infrastrukturës i ka shkëputur kontratën një kompanie punëkryese për shkak të

vonesës nga ana e kompanisë në kryerjen e punimeve.

Nga ana tjetër KDI-së i është bërë i njohur vetëm një rast, kur një kompani ka paditur ministrinë për shkak të shpenzimeve shtesë si pasojë e mospjesëmarrjes së kushteve të punës. Po ashtu, KDI-ja nuk ka hasur në një plan të projektuar nga Ministria e Infrastrukturës, i cili do t'i parashihte hollësitë e realizimit të projektit në tërësi, për asnjërin nga këto dy projekte, ka njoftuar më tej Uka Haxhaj.

Më tutje, ajo shtoi se edhe fenomeni i anekskontratave ka qenë shumë i shprehur gjatë zhvillimit të këtyre projekteve. "Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e mangësive në hartimin e projekteve, por edhe si rrjedhojë e kërkesave të ndryshme të banorëve të zonave rreth

rrugëve për kyçe në rrugë, mbikalime, nënkallime etj", ka thënë ajo.

Vonesat në fillim të punimeve në dy segmente konkrete të këtyre rrugëve (Lum i Madh-Mitrovicë dhe Kijevë-Zahaç) kanë ndodhur si pasojë e vonesës në sigurim të huave të huaja nga ana e qeverisë për ta mbuluar koston financiare.

Duke iu referuar natyrës dhe përsëritjes së problemeve në këto dy projekte, KDI-ja i rekomandon Ministrisë së Infrastrukturës që para fillimit të projekteve infrastrukturore, nëse aplikohet shpronësimi, ta presë përfundimin e procesit të shpronësimit për të filluar pastaj me realizimin e projektit.

Meqë hartimi i projekteve dhe elaboretave të shpronësimit është proces i rëndësishëm për

fillimin e një projekti, Ministria e Infrastrukturës duhet të përzgjedhë kompani sa më të kualifikuar për t'i kryer këto punë dhe t'i mbajë ato përgjegjëse në raste të mangësive në produktet e dorëzuara nga to. Në mënyrë që projektet të realizohen sipas planifikimeve, Ministria e Infrastrukturës duhet t'i kushtojë rëndësi më të madhe procesit të menaxhimit të kontratave dhe të veprojë kur ka gjeçje në projekte. Mbi të gjitha, Ministria e Infrastrukturës duhet ta rrisë transparencën dhe të jetë sa më llogaridhënëse për punën e vet karshi publikut.

Ky raport është produkt i projektit për monitorimin e prokurimit publik në institucionet publike (MI, MSh, AQP dhe KEK), që financohet nga Ambasada Britanike në Prishtinë.

## Ahmeti falënderon USAID-in për mbështetjen e projekteve të ndryshme

**PRISHTINË, 13 NËNTOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka prituri në takim administratorin e USAID-it, Mark Green. Ahmeti ka falënderuar Greenin për ndihmën dhe mbështetjen e vazhdueshme të Shteteve të

Bashkuara të Amerikës (ShBA) përmes projekteve të USAID-it dhe MCC-së për Republikën e Kosovës dhe qytetarët e saj. Në takim është diskutuar edhe qeverisja e mirë dhe bashkëpunimi me USAID-in në projektin TEAM-

Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse, përmes së cilës është duke u synuar përmirësimi i vazhdueshëm në prokurimin publik dhe menaxhimin e fondeve dhe shpenzimeve publike.



## Komuna e Prizrenit synon të përfitojë nga menaxhimi i integruar i aseteve

**PRIZREN, 13 NËNTOR (ER)** - Nën kryetari i Komunës së Prizrenit, Eshref Memaj, ka marrë pjesë në trajnimin për menaxhimin e integruar të aseteve, i cili është duke u bërë me qëllim të ngritjes së kapaciteteve si pjesë e projekteve internacionale për zhvil-

lim. Trajnimi në fjalë është duke u organizuar nga ana Shoqata e Ujësjesve dhe Kanalizimit të Kosovës në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës, në kuadër të projektit "Rrjeti rajonal për zhvillimin e kapaciteteve për shërbimet e

ujit dhe të kanalizimit". Nëpërmjet kësaj Komuna e Prizrenit synon të përfitojë njohuri shtesë për planifikimin, zbatueshmërinë dhe përfitimet nga menaxhimi i integruar i aseteve për infrastrukturën e ujit dhe të kanalizimit.



## Konfiskohen produkte me afat të skaduar në Skenderaj

**SKENDERAJ, 13 NËNTOR (ER)** - Inspektorët komunalë, në kuadër të aktivitetit të tyre ditor, kanë kryer një kontroll rutinë në marketet e fshatit Polac të Komunës së Skenderajt, në të cilët kanë hasur në gjëra ushqimore me afat të skaduar. Pas kontrollit në një market në këtë fshat inspektorët kanë konfiskuar mallin e skaduar dhe kanë bërë asgjësimin e tij.

Ndërsa pronarit të marketit tek i cili janë gjetur artikuj me afat të skaduar i është shqiptuar gjoja konform dispozitave ligjore. Komuna e Skenderajt ka bërë apel të pronarët e marketeve që shesin gjëra ushqimore, të jenë të kujdesshëm me produktet që shesin, kurse nga qytetarët ka kërkuar bashkëpunim për t'i raportuar rastet e tilla.

## Përkrahen me grante bujqit lipjanas

**LIPJAN, 13 NËNTOR (ER)** - Komuna e Lipjanit, në bashkëpunim me organizatën Qatar Charity, të mërkurën kanë bërë shpërndarjen e disa granteve, ku përgjatë vitit 2019 vetëm nga kjo organizatë janë shpërndarë 74 grante, për të cilët ka participuar edhe kjo komunë, siç janë sera bujqë-

sore, motokultivatorë, tufë delesh, shoqëri bletësh dhe artikuj ushqimorë në dyqane. Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, ka falënderuar organizatën Qatar Charity dhe drejtorin e saj, Mahmoud Abbas Shaker, të cilën përgjatë këtij viti ka dhënë shumë grante në këtë

komunë, duke thënë se komuna mirëpret bashkëpunime të tilla edhe gjatë vitit të ardhshëm, sepse ka nevojë për investime në bujqësi. Ndërsa Mahmoud Abbas Shaker është shprehur mirënjohës ndaj kryetarit Ahmeti, duke e falënderuar për bashkëpunim.



## Gjakova, nikoqire e takimit të Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjorë të AKK-së

**GJAKOVË, 13 NËNTOR (ER)** - Komuna e Gjakovës ka qenë nikoqire e takimit të pestë të Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjorë të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK). Në këtë takim zyrtarë ligjorë nga komuna të ndryshme të Kosovës kanë diskutuar rreth Udhëzimit

Administrativ nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane. Ky udhëzim administrativ është miratuar nga MAPL-ja në qershor të këtij viti dhe i obligon komunat që brenda gjashtë muajsh t'i har-

monizojnë rregulloret me këtë udhëzim. Udhëheqësi i Zyrës Ligjore në Komunën e Gjakovës, Frrok Gjergjaj, e ka informuar Kolegjiutin e Zyrtarëve Ligjorë se kjo komunë ka filluar hartimin e rregullores që del nga ky udhëzim administrativ.



# Pas zgjedhjeve të parakohshme në Republikën e Kosovës

"Lista Serbe" ka kontribuar në uljen e paralajmëruar të numrit të ministrave në Qeverinë e Kosovës, e cila ndikon negativisht në të drejtat e komuniteteve joshumicë, veçanërisht boshnjakëve



Cerim BAJRAMI

Në Republikën e Kosovës zgjedhjet e parakohshme për Kuvend u mbajtën më 6 tetor të këtij viti. Dy vjet pas fillimit të mandatit të tij kryeministri Ramush Haradinaj ka dhënë dorëheqje në mes të një thirrje për deklaratë në Gjykatën Speciale. Megjithëkëtë, kjo qeveri nuk kishte një shumicë të qëndrueshme, duke marrë parasysh që edhe kur u formua ajo kishte vetëm një-dy deputetë më shumë se gjysmën e numrit të kërkuar të deputetëve. Ndërkohë, kuvendi dhe qeveria u bojkotuan pothuajse rregullisht nga deputetët e Listës Serbe, me 10 gjithsejtë, nëntë prej të cilëve ishin serbë dhe përfshinin një anëtar të komunitetit goran, megjithëse ata të gjithë ishin zyrtarisht në shumicë parlamentare me koalicionin PAN. Ndërsa deputeti i dhjetë në vendet e garantuara të komunitetit serb ishte i pavarur dhe pothuajse i rregullt në seancat e kuvendit. Arsyeya e mungesës së deputetëve të LS-së është ndjekja e qëndrimeve të qeverisë serbe dhe presidentit të saj, Aleksandar Vuçiq, i cili në këtë mënyrë ndikonte përmes LS për punën e institucioneve të Kosovës. Koalicioni qeveritar i Kosovës gjithashtu përfshiu nëntë deputetë nga komunitetet e tjera joshumicë në vendet e garantuara, duke përfshirë tre boshnjakë: dy nga koalicioni Vakati dhe një nga NDS. Qeveria kishte disa ministra nga Lista Serbe, plus një zëvendëskryeministër, ndërsa nga komuniteti boshnjak një ministër nga koalicioni Vakati dhe një ministër nga komuniteti turk nga partia KDTP. Prandaj, ai bojkot i nëntë anëtarëve të Listës Serbe, plus deputetit të tyre të asociuar të grupit parlamentar të komunitetit goran, u shpreh fuqishëm në këtë mandat të fundit vetëm dyveçar të Qeverisë së Kosovës, por nuk ishte shumë më i mirë as në legjislaturën e kaluar. Kjo do të thotë se Beogradit, pra presidenti serb Vuçiq, donte t'u tregonte krerëve të Kosovës se rregullisht kontrollon zgjedhjet dhe punën e përfaqësuesve të komunitetit serb në Kosovë. Një përgjigje e mundshme nga Kosova është gjetur, qartë: të zbatohet dispozita e Kushtetutës së

Kosovës dhe të zvogëlohet Qeveria e Kosovës në 12 ministra, megjithëse ka 21 portofole ministre në këtë mandat. Sipas Kushtetutës, në rastin deri në 12 ministri vetëm një post ministror i përket komunitetit serb dhe një për komunitetet e tjera joshumicë.

**Për momentin mund të dëgjoen disa zëra nga OJQ relevante në publikun e Kosovës**

Normalisht, askush në publik nuk thotë që arsyeja (kryesore) për uljen e numrit të ministrave është për shkak të serbëve ose komuniteteve të tjera joshumicë. Nga ana tjetër, mandatar i mundshëm për formimin e qeverisë së re nga Vetëvendosja, z. Albin Kurti, bëri disa deklaratë ku ai do ta preferonte shmangien e marrjes së një ministri nga "Lista Serbe" në qeveri për shkak të qëndrimit të tyre dhe mosrespektimit të institucioneve të Kosovës.

Dhe tani lind pyetja në interes të kujt është mosrespektimi, gjithë ajo që Kushtetuta e Kosovës, përkatësisht plani i z. Martit Ahtisaari, mundësoi për komunitetin joshumicë serb, duke numëruar 10 vende të garantuara në kuvend dh, së paku, dy poste ministrash në Qeverinë e Kosovës në rastin e më shumë se 12 ministrave, e që në dy mandate rend përdoren kundër funksionimit të Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës?

Asnjë person racional nuk mund të besojë se kjo sjellje është e përshatshme për tërë komunitetin serb që jeton në Kosovë i cili dëshiron të qëndrojë këtu dhe kjo është shumica e atyre që janë të shpërndarë nëpër komuna ose vendbanime të tjera të Kosovës të banuara (dhe) nga populli serb. Prandaj, kjo lojë shumëvjeçare e Beogradit dhe "Listës Srpska" përshtatet vetëm me politikën aktuale serbe të udhëhequr aktualisht nga presidenti serb Vuçiq, i cili po e shkatëron pozicionin aktual ligjor dhe politik për komunitetet joshumicë, vetëm për të arritur gjoja "qëllime më të larta" në dialogun aktual Kosovë - Serbi.

Në anën tjetër, sado që kjo heshtet edhe nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, kjo lojë e parapërmendur i bën një dëm të madh përfshirjes së komuniteteve joshumicë në sistemin përfaqësues, sepse një sjellje e tillë në praktikë konfirmohet si jofunksionale.

Dhe ajo që është e rëndësishme për ne "komunitetet e tjera joshu-

micë" - pasojat e politikës së tillë serbe dhe LS-së do t'i bartin edhe komunitetet e tjera të Kosovës të cilat janë gjithsej 10 deputetë të garantuar, po aq sa komuniteti serb. Për ta bërë paradoksin edhe më të madh, nëntë deputetë nga komunitetet e tjera joshumicë: boshnjakët (3), turqit (2), romët, ashkalitë dhe egjiptianët (gjithsej 4) kanë qenë gjithmonë aktive në Kuvendin e Kosovës dhe kanë votuar rregullisht në interes të shtetit të Kosovës dhe udhëzimeve kryesore politike të shumicës së qeverisë dhe kuvendit.

Sidoqoftë, në këto trazira dhe heshtje të përgjithshme për zvogëlimin e ministrave në Qeverinë e Kosovës nuk është e parëndësishme që disa deputetë të komuniteteve të tjera shpesh keqtrajtoheshin nga disa përfaqësues të shumicës, zbatoheshin me lehtësi në premtimet e tyre për interesat e komuniteteve të tyre, nuk ishin unikë, duke luajtur kështu një lojë të ndërsjellë pozitë-opozitë në kuvend etj. Disa deputetë boshnjakë veçmas ishin të njohur për këtë në disa legjislatura të kuvendit. Megjithëse paralajmërimi aktual për aë ulur numrin e ministrave në Qeverinë e Kosovës justifikohet nga nevoja për racionalizim, për momentin mund të dëgjoen disa zëra nga OJQ relevante në publikun e Kosovës - se ulja e papritur dhe bashkimi i disa ministrave në një të vetme në Qeverinë e Kosovës do të shkaktojë shumë çrregullime funksionale.

**Boshnjakët e Kosovës përsëri në pozitë të keqe rreth pozitës ministrore**

Në lidhje me këtë, duket se ne boshnjakët e Kosovës përsëri jemi në një pozitë të keqe rreth pozitës ministrore, madje qysh nga shpallja e pavarësisë së Kosovës për herë të parë në mandatit e fundit të shkurtuar kemi pasur mundësinë të marrim një ministri pa portofol,

me pothuajse aspak buxhet. Ndërsa në këtë - edhe më teknik - mandatit qeveritar të kryeministrit Haradinaj, boshnjakëve, përmes një përfaqësuesi mazhoritar të koalicionit Vakati, iu dha pozita e ministrit për Zhvillim Rajonal (ministri Rasim Demiri), me një buxhet modest, por prapë bëri kontribute të dukshme nëpër rajone në të gjithë Kosovën, veçmas u bë një veprim për ta riparuar minusin e investimeve në infrastrukturë në lokalitetet e komunitetit me shumicë boshnjake dhe komuniteteve të tjera.

E gjithë kjo tani po vihat në pikëpyetje ku boshnjakët, së bashku me turqit, romët, egjiptianët dhe ashkalinjtë, janë duke u vendosur në pozitë të betejës së brendshme për avantazh ndaj pozitës së ministrit dhe për ta "bindur" njëri-tjetrin se cili deri më tani ka qenë ministër më së gjati, kush është më i aftë, kush duhet të jetë në qeveri etj. Përveç kësaj, tani që opozita e vjetruar tashmë nga NDS, në formën e një personi që ka shpenzuar disa mandate parlamentare kundër koalicionit mazhoritar të Vakati i cili mban rregullisht dy deputetë në vendet e garantuara për boshnjakë në disa përbërje, e cila prapë tani po bën çmos për ta shmangur fitoren e postit të ministrit për boshnjakë.

Sidoqoftë, çdo mandatar racional nuk duhet të mbështetet në 'bingo' e goditur nga disa deputetë të përjetshëm nga komunitetet pakicë, shqetësimi personal i të cilëve në Kuvend ishte pozicionimi i tyre personal, por duhet marrë parasysh disa nga faktet shumë të rëndësishme. Dhe një nga faktet është se boshnjakët e Kosovës janë bashkësia e tretë më e madhe etnike në Republikën e Kosovës, kanë status të trashëguar ligjor dhe politik, dhe kanë të gjitha atributet e kombësisë: ata përdorin gjuhën e tyre boshnjake në mësimet shkollore, informimin, pjesërisht dhe në përdorim zyrtar etj. (Të drejta gjuhë-

sore të ngjashme ka vetëm bashkësia kombëtare turke, e katërta në numër).

Po ashtu, është i rëndësishëm fakti që boshnjakët e Kosovës, me numrin e tyre të votave, veçanërisht në komunën e Prizrenit, kanë treguar se ata nuk janë "përfaqësues sadakë", por që kanë një elektorat serioz dhe se koalicioni Vakati është entiteti politik më i votuar midis opsioneve të pakicave, si dhe kryetari i saj Rasim Demiri.

Më e rëndësishmja, nevoja për një prani të drejtpërdrejtë të qeverisë, është që boshnjakët e Kosovës ende janë duke pritur për një zgjidhje të qëndrueshme për disa nga problemet e tyre kolektive kombëtare, të cilat institucionet e Kosovës po i zgjasin, edhe pse Kushtetuta dhe ligjet e garantojnë atë. Për shembull: kërkohet përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në gjuhën boshnjake, adresimi i mungesës së teksteve shkollore dhe dokumentacionit në gjuhën boshnjake, çështja e decentralizimit, çështja e marrëdhënieve të Kosovës me Bosnjë dhe Hercegovinën dhe heqja e një regjimi të rreptë të vizave, përmirësimi i mëtejshëm institucional i marrëdhënieve me diasporën boshnjake, çështja e punësimit boshnjak dhe gradimi në të gjitha shërbimet shtetërore dhe publike, mbrojtja e mjedisit dhe moslëshimi i mëtejshëm i lejeve për ndërtimin e hidrocentraleve në Zhupë afër Prizrenit. (Ndaluar nga angazhimi ynë i madh institucional me mbështetjen e popullit, në vitin 2016).

Megjithëse dihet pak a shumë se shumë nga këto probleme kanë qenë dhe shpesh janë potencuar, disa të zgjidhura, ka qenë mjaft e vështirë edhe me ne brenda institucioneve shtetërore. Neve nuk na nevojitet shumë 'moderim' për të ditur se si do të ishte pa përfaqësuesit e zgjedhur boshnjakë brenda tyre!

(Përkthim nga gjuha boshnjake: Fatmir Neziri)



## Vazhdojnë tensionet në mes të Izraelit dhe militantëve palestinezë

TEL AVIV, 13 NËNTOR - Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu tha të mërkurën se ndërsa Izraeli nuk dëshiron përshkallëzimin e dhunës së fundit me militantët palestinezë në Rripin e Gazës, vendi i tij do të reagojë ndaj çdo sulmi. Duke folur para fillimit të një takimi të kabinetit, Netanyahu tha se grupi Xhahadi Islamik ka zgjedhjen që "t'i ndalojë sulmet ose të përballet

me sulme të tjera". Forcat izraelite ndërmorën sulme ajrore të mërkurën në Rripin e Gazës, ndërsa militantët hodhën raketa drejt Izraelit. Zyrtarët palestinezë të shëndetësisë njoftuan për të paktën 18 palestinezë të vrarë që nga fillimi i luftimeve të martën. Nuk ka pasur njoftime për viktima nga pala izraelite. Ushtria izraelite tha se militantët palestinezë kishin hedhur më shumë se 200

raketa drejt Izraelit. Zjarri me raketa ishte një kundërpërgjigje ndaj një sulmi ajror izraelit, në të cilin u vra një komandant i grupit Xhahadi Islamik në Rripin e Gazës.

Kryeministri Netanyahu tha se komandanti Bahaa Abu el-Atta ishte përgjegjës për shumë prej sulmeve me raketa nga Rripi i Gazës drejt Izraelit dhe se ai kishte planifikuar sulme të mëtejshme.



## Hetimi ndaj Trumpit, fillojnë seancat publike me dëshmi

Diplomatët George Kent dhe William Taylor në dëshminë e tyre shprehën shqetësim të qartë lidhur me presionin ndaj Ukrainës duke pezulluar ndihmat dhe për praktikën e ndjekur në kontaktet me udhëheqjen ukrainase që anashkalonte linjat zyrtare të komunikimit

WASHINGTON, 13 NËNTOR - Dy figura qendrore në procesin hetimor mbi presidentin Trump kanë ofruar të mërkurën për të dytën herë variantin e tyre të ngjarjeve në dëshmi para ligjvënësve. Dëshmitë e tyre janë të parat që bëhen në seanca publike në kuadër të hetimeve që mund të çojnë në procesin për shkarkimin e mundshëm të presidentit Donald Trump. Zëvendësndihmëssekretari i Shtetit për Evropën, George Kent dhe ambasadori amerikan në Ukrainë, William Taylor, u janë përgjigjur pyetjeve të ligjvënësve lidhur me kontaktet e presidentit me udhëheqësin ukrainas, të cilat, sipas demokratëve, përbëjnë shkelje të autoritetit për përfitim politik personal, ka njoftuar voa. Kjo është hera e dytë që ambasadori Taylor dhe zëvendësndihmëssekretari i Shtetit, Kent, dëshmojnë para ligjvënësve në Komisionin e Dhomës së Përfaqësuesve për Zbulimin. Por, për herë të parë ata japin dëshmi në seanca me detyrë të hapura, pas këmbënguljes së republikanëve se demokratët po zhvillonin hetime në fshehtësi. Të dy ata në dëshminë e tyre

shprehën shqetësim të qartë lidhur me presionin ndaj Ukrainës duke pezulluar ndihmat dhe për praktikën e ndjekur në kontaktet me udhëheqjen ukrainase që anashkalonte linjat zyrtare të komunikimit.

Zëvendësndihmëssekretari i Shtetit, George Kent, foli për rëndësinë e luftës kundër korrupsionit në Ukrainë, por ai shprehu kritika ndaj praktikave të ndjekura të cilat janë në qendër të hetimeve dhe që ai i përshkroi si akte që minojnë sundimin e ligjit: "Bazuar në parimet e përgjithshme, nuk besoj se Shtetet e Bashkuara duhet t'u kërkojnë vendeve të tjera të angazhohen në hetime apo ndjekje penale të përzgjedhura dhe me ngjirim politik, kundër kundërshtarëve të atyre që janë në pushtet, pasi akte të tilla të specifikuara minojnë shtetin ligjor, pavarësisht se me cilin vend bëhet kjo tentative", tha ai.

Kenti foli për Burismën dhe shqetësimet që kishin pasur zyrtarët amerikanë për korrupsion nga drejtuesi i kësaj kompanie si dhe për problemin e përfshirjes në bordin drejtues të kësaj kompanie të djalit të ish-nënpresi-



dentit Biden. Por ai nënvizoi se hetimet lidhur me shqetësimet për korrupsion duhet të zhvillohen nga institucione ligjore e jo përmes presionit nga zyrtarë individualë.

Në mbyllje të dëshmisë së tij ai veçoi shqetësimet lidhur me veprimet e Rudy Giuliani për të diskredituar, siç përshkroi ai, diplomatë amerikanë dhe shprehu tronditjen që tha se kishte ndier kur këto përpjekje çuan në largimin nga detyra të ambasadores amerikane në Ukrainë, Marie Yovanovitch.

Yovanovitch është një ndër zyrtarët e tjerë të thirrur për të dëshmuar gjatë javës.

Shqetësimet të ngritura nga zëvendësndihmëssekretari i Shtetit, George Kent, u bëri jehonë edhe ambasadori amerikan në Ukrainë, William Taylor, i cili e mori fjalën më pas. Ai shprehu kritika ndaj presionit

që i ishte bërë udhëheqjes së Ukrainës nga kanale jozyrtare komunikimesh, që anashkalonin institucionet e rregullta. "Po balafaqohesha me një linjë jozyrtare, të parregullt komunikimesh lidhur me Ukrainën, që nuk jepte llogari para Kongresit, një linjë që nuk respektonte praktikën e komunikimit përmes Departamentit të Shtetit. U bëra gjithnjë e më i shqetësuar nga operimet e kësaj linje që përfshinte përfaqësuesin e presidentit Trump për Ukrainën, Kurt Volker, ambasadorin amerikan në BE, Gordon Sondland, Sekretarin e Energjetikës, Rick Perry, zyrtarin e Shtëpisë së Bardhë, Mick Mulvaney dhe avokatin personal të presidentit Rudy Giuliani", tha Taylor.

Ai vazhdoi të jepte hollësi të bisedave dhe shkëmbimeve si brenda zyrtarëve në këtë linjë komunikimesh si dhe kërkesave që ata

u kishin përcjellë udhëheqjes së Ukrainës. "U shqetësova pasi linja e parregullt apo jozyrtare po vepron në kundërshtim me interesat e politikës së jashtme amerikane kundrejt Ukrainës", u shpreh Taylor.

Ai përmendi se këto akte e kishin shtyrë deri pranë dorëheqjes.

Në qendër të debatit është telefonata e 25 korrikut në mes të Trumpit dhe homologut ukrainas Volodimir Zelenski, të cilit presidenti amerikan i kërkoi të hapte hetime mbi pretendentin demokrat në zgjedhjet presidenciale, Joe Biden, punësimin e të birit, Hunter Biden, në një kompani energjetike ukrainase si dhe teorinë, tashmë të rrëzuar, se Ukraina kishte ndërhyrë në zgjedhjet amerikane të 2016-s. Në momentin e telefonatës presidenti kishte ngrirë 391 milionë dollarë ndihma ushtarake për Ukrainën.



## Përshkallëzohet dhuna në Hong Kong

HONG KONG, 13 NËNTOR - Hong Kongu po vazhdon të përballet me protesta antiqeveritare. Raportohet për përleshje mes protestuesve dhe policisë në Universitetin Kinez të Hong Kongut. Policia ka gjuajtur gaz lotsjellës dhe plumba gome, ndërsa protestuesit hodhën bomba benzine në drejtim të policisë. Përleshje kishte edhe në pjesë të tjera të qytetit.

Byroja e Arsimit ka njoftuar se të gjitha shkollat do t'i pezullojnë mësimet ditën e enjte për arsye sigurie.

Një seancë në parlamentin e qytetit, i njohur si Këshilli Legjislativ, u ndërpre pak kohë pasi politikanët e opozitës morën në pyetje shefin e sigurisë lidhur me brutalitetin e dyshuar të policisë.

Përshkallëzimi i dhunës në Hong

Kong u rikthye pas vdekjes së një studenti 22-vjeçar gjatë një operacioni të policisë një javë më parë.

Hong Kongu është pjesë e Kinës, por si ish-koloni britanike gëzon një autonomi të gjerë dhe njerëzit kanë më shumë të drejta sesa në pjesë të tjera të Kinës. Protestat filluan në qershor kundër planeve për ta lejuar ekstradimin në territorin e Kinës.



## AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:  
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**

**E rrallë**

## Mbreti i një prej vendeve më të varfra blen makina luksi për 14 gratë

Anëtarët e opozitës kanë thënë se me këtë veprim mbreti ua ka nxjerrë gishtin e mesit të varfërve në vendin e tij, Zvaziland. Mbreti Msvati III ka importuar 19 IIs Royce dhe 120 BMW, të cilat kanë nisur të dërgohen në fillim të muajit. Sipas dëshmitarëve, makinat



janë të reja dhe të shtrenjta dhe banori mesatar i Zvazilandit do të duhej të punonte për 70 vjet për ta paguar një veturë të tillë.

**FOTO E DITES**



Një grua shihet e mbështjellë duke u mbrojtur nga dëborat afër liqenit Michigan në Chicago. /AP/

**E jashtëzakonshme**

## Merr flakë gjatë zbritjes avioni me 196 persona në bord

Pamjet dramatike tregojnë se si një avion me 196 udhëtarë në bord ka marrë flakë menjëherë pasi ka zbritur në aeroportin e Sharm El Sheikut në Egjipt. Avioni Boeing 737-800 po drejtohej nga kompania SkyUp nga Ukraina. Ai arriti të zbrisë pa asnjë problem në aeroportin bregdetar. Avioni shkoi të



parkohet te vendi i tij, kur papritur shpërthyen flakët e para te pjesa e majtë e mekanizmit të uljes. Të 189 udhëtarët dhe shtatë anëtarët e ekuipazhit kanë arritur të zbrisen pa lëndime.

**BARSOLETA E DITËS**



**Profesori: Mos u shtrij në bankë!  
Nxënësi: Pse?  
Profesori: Nuk je në kafe, por në klasë.  
Nxënësi: As ti prof mos u sill, se nuk je kamerier!**



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Vetem gjatë vikendit në ora 14:00

### ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.  
Regjia: Jill Culton



Çdo ditë në ora 16:00

### TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.  
Regjia: Josh Cooley



Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

### MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.  
Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

### ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

|   |   |   |  |  |  |
|---|---|---|--|--|--|
|  <p><b>DASHI</b><br/>Nëse po punoni nga shtëpia sot, mos mendoni se nuk do të lodheni.</p>   |  <p><b>DEMI</b><br/>Një letër e çuditshme ose telefonatë mund t'ju vijë sot. Mund të jetë lajm i mirë ose i keq.</p> |  <p><b>BINJAKËT</b><br/>Sot duhet ta përdorni logjikën. Ju mund të merrni një letër të papritur ose telefonatë që ka të bëjë me paratë.</p>                    |  <p><b>GAFORRJA</b><br/>Zakonisht ju keni përqendrim të mirë, por sot do të hasni disa pengesa.</p>        |  <p><b>LUANI</b><br/>Sot intuata juaj mund të dallojë se ka diçka që nuk shkon me mendimet e ndjenjat e vëllait, motrës ose një personi tjetër.</p> |  <p><b>VIRGJËRËSHA</b><br/>Sot do të merrni një informacion rreth një grupi ku merrni pjesë dhe do të mendoni nëse duhet të qëndroni ende me ta apo jo.</p> |
|  <p><b>PESHORJA</b><br/>Zakonisht, mendja juaj është e mprehtë dhe e përqendruar, por sot do të kuptoni se nuk mendoni dot në mënyrën e duhur.</p> |  <p><b>AKREPI</b><br/>Zakonisht, ju bazoheni tek intuata, por sot do t'ju komandojnë ndjenjat.</p>                   |  <p><b>SHIGJETARI</b><br/>Sot do të zgjoheni në gjendje jonormale. Kjo sepse gjatë natës keni parë një ëndërr të çuditshme dhe shqetësuese rreth një miku.</p> |  <p><b>BRICJAPI</b><br/>Mungesa e komunikimit mes jush dhe dikujt tjetër mund të shkaktojë keqkuptime.</p> |  <p><b>UJORI</b><br/>Dita në punë do të jetë aq intensive sa nuk do të dëgjoni çfarë ju thonë të tjerët.</p>  |  <p><b>PESHQIT</b><br/>Nëse jeni në një lidhje dashurie, do të kuptoni se një prej jush është shumë pasionant, por tjetri jo.</p>                           |

## Renee Zellweger tregon arsyen se pse u largua nga aktrimi



**A**ktorja e njohur amerikane, Renee Zellweger, ka treguar arsyet se pse ka vendosur të mos jetë për disa vjet në fushën e aktrimit. Ajo ka thënë se kishte disa gjëra në jetën e saj që ajo dëshironte t'i jepte përparësi para karrierës së saj të aktrimit, siç


ishite gjetja e dashurisë. "Ngadalësimi dhe puna për të ndërtuar një jetë për veten time. Duke u munduar të mos kem marrëdhënie kur po largohem nga qyteti çdo dy javë. E dini, duke u njohur me dikë, bie në dashuri", ka deklaruar Zellwegeri.

## Demi e konfirmon lidhjen e re



**D**emi Lovato e ka një njeri të ri në jetën e vet dhe këtë e bëri publike në "Instagram". Këngëtarja 27-vjeçare është në lidhje me modelin Austin

Wilson dhe për ta konfirmuar këtë lidhje ajo postoi një fotografi me të. "My Love", ka shkruar Demi Lovato. Austin është model me bazë në Los Anxhelos.



## Dua Lipa, një 'indiane' tradicionale

**K**ëngëtarja kosovare me famë botërore, Dua Lipa, është paraqitur në "Instagram" me një veshje krejtësisht ndryshe nga siç jemi mësuar ta shohim. E mbuluar me një shami të kaltër, ajo ka pozuar e buzëqeshur para kamerës dhe këtë fotografi e

postoi për ndjekësit e cila për pak orë mbledhi mbi një milion pëlqime. "E emocionuar të rikthehem në Indi këtë javë! Asnjëherë nuk e kam pasur rastin të performoj para jush dhe jam e lumtur që do ta ndaj skenën me Katy Perryn. Yaaaaa", ka shkruar ajo.

## Shakira thotë se problemet me zërin e kishin çuar në depresion



**S**hakira është hapur për trajtimin e çështjeve të shëndetit mendor pasi pësoi një dëmtim kërcënues për karrierën dy vjet më parë. "Unë nuk isha pozitive, por isha shumë pesimiste", ka thënë ajo për "Guardian". Në vitin 2017 Shakira pësoi një hemorragji të kordonit vokal. Si rezultat asaj i është dashur të

shtyjë një pjesë të turneut botëror "El Dorado". "Unë gjithmonë kam menduar se do të ketë gjëra në jetën time që do të largoheshin, si bukuria, rinia, të gjitha ato gjëra, por kurrë nuk kam menduar që zëri im do të më linte, sepse është kaq e natyrshme për natyrën time. Ishte identiteti im", ka thënë ajo.

# 'Si bëhet njeriu artist?'

"Çfarë e bën një prodhim artistik, si bëhet njeriu artist?", shkrimtari sloven Tada Golob i largohet luftës, si linjë magnetizuese për letërsinë bashkëkohore dhe tenton të hulumtojë mbi kuptimin e artit dhe rreth asaj që nxit individin të krijojë.

Librin e tij të parë, "Këmbët e derrit" (botim i shtëpisë botuese "Toena"), me të cilin nis të bëhet i njohur dhe fiton edhe çmimin prestigjioz "Kersnik", e sjell në shqip Nikollë Berisha. Ngjitja e Golob në letërsi që e menjëher-shme, njësoj siç ndodhi me mbërritjen e tij në majën e Everestit, dy ditë pasi u bë pjesë e ekipit mbështetës për Dav Karničarin (njeriut të parë që zbriti nga maja e Everestit me ski).

Pas "Këmbët e derrit", ai botoi disa libra të tjerë të suksesshëm, si "Dhëmbi i artë", "Ku humbi Brina", "Liçeni", "Derrat meshkuj" etj. Si për çdo personazh të tij, edhe për Jani Bevkun të "Këmbët e Derrit", Golob tregon se është mbështetur në personazhe reale, ndërsa zhvillimi i rrëfimit, shpalosja e fundi, kanë si lëndë të parë fantazinë.

Edhe pse dozat e erotizmit në libër kanë ngjallur jo pak debate, shkrimtari shprehet.

"Për sa u përket skenave seksuale në "Këmbët e derrit, jam shumë krenar. Të përshkruhet seksi në mënyrë që të mos duket si pornografi dhe njëherazi që njerëzit të mos qeshin, është shumë vështirë". Përpos kësaj, për pjesë të tjera që ai i konsideron si "gangsterike", si ajo e pushkës së prerë, e qeskës së kokainës, shkrimtari tregon se është bazuar në ngjarje reale.

**"Këmbët e derrit" është një roman që ju solli shumë sukses. Me të, ju fituat edhe çmimin më të rëndësishëm për letërsi në Sloveni "Kersnik". Çfarë ju frymëzoi të shkruani një vepër të këtij lloji, me një subjekt gati-gati të pazakontë, i cili, le të themi, ka tërhequr mjaft kërshërinë e lexuesve?**

Në të vërtetë, e kam shumë të vështirë ta shpjegoj këtë gjë. "Këmbët e derrit" ka qenë libri im i parë letrar dhe në të unë shtroj pyetjen: Çfarë është arti? Flet për një vizatues të tatuazheve, që ka probleme me kokainën, mungesën e parave, si dhe me personalitetin e tij. Megjithatë, boshti kryesor ku libri mbështetet mbetet: Çfarë e bën një prodhim artistik, si bëhet njeriu artist? Kjo ishte çështja që më mundonte së tepërmi kur vendosa të shkruaj. Nuk e gjeja veten në mesin e atyre që merren tërësisht me tema "serioze". Nuk desha të shkruaja për përçarjen kombëtare në Luftën e Dytë Botërore.

**Prej 30 vjetësh merreni me alpinizëm dhe keni ngjitur edhe majën më të lartë, atë të Everestit. Ç'mund të na thoni për këtë eksperiencë dhe mbi të gjitha për pasionin tuaj për letërsinë? A kanë këto dy pasione pika takimi?**

Po, ekzistojnë shumë pika takimi mes tyre. Vetë ndjesia që përjeton kur gjendesh rrëzë një shkëmbi të madh mbi të cilin dëshiron të ngjitesh, ashtu si edhe kur shkruan fjalinë e parë që do të duhet të bëhet roman, janë të ngjashme. Ka të bëjë me atë ndjesinë e vogëlsisë. Përpos kësaj, angazhimi në sport të hap një dritare të rëndësishme të botës dhe jetës. Në Everest, në fakt, shkova në vitin 2000, si pjesëtar i ekipit mbështetës për Dav Karničarin, njeriun e parë në botë që zbriti nga maja e Everestit me ski. Dy ditë më vonë, më 9 tetor, edhe unë mbërrita në majë.

**Në këtë roman, protagonistin, Jani, përjeton ulje e ngritje të shumta dhe e gjitha është rrëfyer përmes një monologu të brendshëm. A ka elemente të këtij subjekti, që bazohen në jetën tuaj reale, apo është thjesht një trill artistik?**

Kur unë shkruaj, kur krijoj personazhet e librave të mi, gjithmonë mbështetem në persona reale. As Jani Bevku, nuk është krejtësisht i trilluar. E kam një mik që flet ngjashëm me të, me një gjuhë tejet vulgare, e që përdor sharje dhe mallkime; as pjesa "gangsterike" e tregimit me pushkë të prerë dhe me qeskë të kokainës nuk është e trilluar. Ndërsa, vetë rrëfimi, shpalosja dhe fundi i saj janë plotësisht prodhim i imagjinatës.

**Përgjatë romanit kemi mjaft skena erotike. Raportet, deri edhe më intimitet të personazhit me gruan e tij, janë të përshkruara me një gjuhë mjaft të drejtpërdrejtë. Mendoni se gjuha e përdorur e bën romanin të lexohet më shumë? Pra, a ka qenë një zgjedhje e paramenduar ajo e përshkrimit përmes një gjuhe të tillë?**

Gjuhën që përdor, gjithmonë ia përshtat personazheve dhe situatave. Shumë njerëz e kanë kritikuar "Këmbët e derrit" për vulgarizimin. Ç'të them...? Po, është vulgare, ashtu siç është edhe jeta e Jani Bevkut dhe jetët tona në përgjithësi. E për sa u përket skenave seksuale - për to, në "Këmbët e derrit", jam shumë krenar. Të përshkruhet seksi në mënyrë që të mos duket si pornografi, e që



njerëzit të mos qeshin, është shumë vështirë.

**Subjektin e romanit mund ta lidhim edhe me aktualitetin, me problemet e ndryshme sociale, marrëdhëniet mes një çifti, të cilat agravojnë në momentin e përballjes me trysnitë që shpesh të sjell jeta. Përse zgjodhët një bërthamë të tillë për romanin tuaj, që vërtet rreth problemeve, vështirësive të një çifti?**

Heroi duhet të merret me probleme, përndryshe nuk është hero. Problemet që ka një njeri me familje, pa para dhe pa të ardhme, kuptohet se janë shumë më të mëdha se problemet e një njeriu të pamartuar në një situatë të njëjtë.

**Jeni i frymëzuar nga mitologjia greke, sepse në roman hasen tek-tuk motive mitologjike, si për shembull ai i bretkosës?**

Më pëlqen shumë mitologjia greke, por ato bretkosa nuk rrjedhin prej saj. Janë ngjarje që vërtet më kanë ndodhur para afro pesëmbëdhjetë vjetësh, kur me bashkëshorten dhe me dy fëmijët e vegjël u shpërngulëm në një banesë-bodrum në periferi të Lubjanës. Në vjeshtë, kur filluan reshjet, para dyerve kishim një mori bretkosash. Më vonë zbulova se shtëpia që kishim blerë, ishte

ndërtuar mbi një moçal që nuk mund të thahej. Kjo pjesë e romanit është tejet autobiografike.

**Përse zgjodhët titullin "Këmbët e derrit" për romanin tuaj? Menduat se do ta tërhiqte më shumë lexuesin?**

Për arsye se Jani Bevku, ndër kohë që mësohej të bënte tatuazhe, ushtrohej me "këmbët e derrit", të cilat i blinte në dyqanin e mishit. Dhe kur i pa këmbët me ato thundra të shtypura, para sysh iu shfaq rrëfimi i jetës së kësaj kafshe. Dhe ky rrëfim është i egër.

**Cili është shkrimtari juaj i preferuar dhe çfarë lloj letërsie lexoni?**

I kam pesë libra të preferuar që i citoj kur ma bëjnë këtë pyetje: "Mjeshtri dhe Margarita" e Bulgakovit, "I huaji" i Albert Camus, "Cica në metro" i Raymond Queaneaut, "Shpëtimi" i James Dickeys dhe "Thertorja pesë" e Kurt Vonnegutit. Përndryshe, lexoj gjithçka.

**Ç'duhet të përmbajë një shkrim që të quhet letërsi e mirëfilltë, sipas jush?**

Duhet të ketë diçka që ta tërheq lexuesin. Rrëfimin, gjuhën, energjinë, elemente që në thelb është e vështirë t'i përcaktosh, pasi çdo njeri i percepton disi ndryshe.

Nuk janë të gjithë librat për gjithkënd. As "Këmbët e derrit" nuk është.

**Vendi juaj i preferuar për të shkruar?**

Shkruaj në shtëpi. Në dhomën e gjumit kam rregulluar një qoshe për të shkruar. Edhe pse kam shkruar edhe në vende të tjera; në banesa, në rezidenca të ndryshme për shkrimtarët, nëpër kafene etj. Mirëpo, jam mësuar me ambientin shtëpiak dhe mendoj se shkrimet e mia më të mira krijohen pikërisht aty.

**Përveç romaneve, cila gjini letrare ju pëlqen më shumë dhe a keni menduar ta sprovoni veten në poezi?**

E kam provuar, por në këtë botë ka aq poetë të shkëlqyer, sa nuk do t'u përzihesha në punët e tyre. Në slovenët kemi më shumë poetë se shkrimtarë të jashtëzakonshëm.

**Për ta përmbyllur, donim t'ju kërkonim një këshillë për krijuesit e rinj. Çfarë duhet të kenë parasysh në momentin që shkruajnë?**

Asgjë, vërtet për asgjë nuk do të guxoja t'i këshilloj. Të gjitha do të duhet t'i mësojnë vetë, madje edhe nga gabimet e tyre mund të mësojnë. /Panorama.al



# Janis Kalpuzos: Dhimbja nuk bën dallim mes kombësive dhe racave


Atë që ndodh në Suhum, në vigjilje të dasmës së Talinës me Galinos, kur i dyti kishte shtatë vjet që kishte shkëputur çdo kontakt me bashkëshorten e tij të ligjshme, është një ngjarje reale, që ka ndodhur madje në rajonin e Abhazisë". Janis Kalpuzos, shkrimtari grek që vjen në shqip me romanin "Serra, shpirti i Pontit" (Toena) rrëfëhet për librin e tij në "Gazeta Shqiptare". "Shtysën e parë e mora prej sime motre, që më mundësoi të takohem me disa banorë të Pontit, të cilët patën ardhur në Vigla të Artës prej Kazakistanit në vitin 1959", thotë ai duke na ftuar në botë të reja letrare.

**– Teksa lexojmë veprën tuaj "Serra", vihet re që për nga gjerësia e shprehjes ngjan disi me rrëfimin tolstolian. Ka ndikuar ky shkrimtar në shkrimet tuaja?**

Unë jam rritur në një fshat të vogël të Epirit, në të cilin letërsia si nocion ishte diçka e panjohur. Më duhet të them se fillova të lexoj letërsi në moshën njëzet e një vjeçare. Pra, në një moshë mjaft të madhe që të ndikohesha thellësisht nga cilido shkrimtar. Ndoshta, pa e kuptuar as vetë, mund të kenë ndikuar në stilin dhe në mënyrën time të të shkruarit me dhjetëra shkrimtarë, por e kam të pamundur ndërkohë që të përmend dikë me emër. Mendoj se më shumë kanë ndikuar tek unë gjyshërit dhe gjyshet në fshatin tim, teksa i dëgjoja të tregonin histori dhe legjenda.

**– Në vepër përshkruhet dashuria e madhe dhe plot peripeci mes Galinosit, personazhit kryesor dhe Talinës, një vajze armene. Krijimi i këtyre dy personazheve dhe dashuria e tyre bazohet në ndonjë ngjarje të vërtetë, ndoshta edhe në ndonjë ndodhi tuajën personale?**

Të gjithë personazhet e romanit "Serra" janë ndërtuar duke pasur parasysh kohën kur jetuan, përsa u përket mentaliteteve, mënyrës së sjelljes apo dhe parimeve morale. Nuk kam pasur parasysh një eksperiencë apo dhe rrëfime respektive, megjithëse unë kam njohur njerëz që do të mund të reagonin apo dhe të kishin mëdyshje, ashtu siç vepronte Galinos. Përsa i përket 'fiction'-it, kam përfshirë në libër dhe disa ngjarje reale. Për shembull: Atë që ndodh në Suhum, në vigjilje të dasmës së Talinës me Galinos, kur i dyti kishte shtatë vjet që kishte shkëputur çdo kontakt me bashkëshorten e tij të ligjshme, është një ngjarje reale, që ka ndodhur madje në rajonin e Abhazisë. Nuk po flas më tepër, por kur lexuesit do të lexojnë librin, do ta kuptojnë.



**– Në romanin tuaj ka shumë emra vendesh dhe personazhesh historike. A mund ta bëjë kjo lexuesin ta shohë si një dokumentar historik më shumë sesa si një roman historik?**

Në asnjë rast. Në roman mbi-zotëron 'fiction'-i së bashku me gjuhën, personazhet dhe tematikën. Nga ana ime pati një përpjekje të stërmundimshme, nëpërmjet hulumtimeve lodhëse dhe që zgjatën në kohë, në mënyrë që të arrija të rindërtoja që nga nënshtrësia e saj, një epokë që nuk ekziston më, në mënyrën më të saktë të mundshme. Dhe këtë e bëra për tri arsye: Në mënyrë që lexuesi t'i përfytyroj në një trajtë sa më të dokumentuar ngjarjet e përshkruara, të përfytyroj njohuri prej tyre, diçka që e konsideroj si pjesë përbërëse të letërsisë dhe e treta, për të gjykuar vetë lexuesi për personazhet, për vendimet që ata marrin, për vetë epokën në të cilën jetojnë dhe për gjithçka që libri trajton, në bazë të parimeve të atëhershme dhe jo sipas mënyrës së sotme të të menduarit ose në bazë të njohurive që ne kemi sot për botën.

**– Librin mund ta shohim jo vetëm si një histori të dhimbshme të banorëve të Pontit, por edhe si një histori të "njeriut që ngec në ingranazhin historik", që varet nga vendimet politike. Kjo tingëllon disi aktuale edhe sot me valën e emigracionit nëpër botë, sepse edhe në roman kemi lëvizje populatash nëpër vende të ndryshme. Cili është pozicioni juaj lidhur me këtë çështje?**

Unë përfiqem në çdonjërin prej librave të mi, që nëpërmjet së kaluarës, të flas për të sotmen dhe për të nesërmen. Vetëm atëherë letërsia ka vlerë. Madje, edhe kur zbulojmë si ka ndikuar te ne ndryshimi duke na bërë këta që

jemi sot. Përpos kësaj, pak gjëra që kanë lidhje me shpirtëroren kanë ndryshuar gjatë rrjedhës së shekujve. Ndërkaq, me të njëjtën mënyrë përballen njerëzit e çdo epoke, me vërshimet që u rezervon atyre jeta dhe vorbulla e historisë, ashtu si ju me të drejtë iu referuat valëve të emigrantëve. Dhimbja nuk bën dallim mes kombësive dhe racave. Në thelb, romani "Serra" është mbi të gjitha, një libër human.

**– Kur vendosët të shkruani këtë roman, që ka kaq shumë dhimbje, tragedi e mister? Si ndikoi kjo në gjendjen tuaj emocionale teksa përshkruanit personazhe si Galinos dhe Talina, Fejzel Kiulkan apo edhe Hamza Hafizi?**

Shtysën e parë e mora prej sime motre, që më mundësoi të takohem me disa banorë të Pontit, të cilët patën ardhur në Vigla të Artës prej Kazakistanit në vitin 1959. Zjarri që ata ndezën tek unë u shumëfishua gjatë shkrimit të librit. Sepse gjatë shkrimit unë bëhem një me çdo personazh që krijoj, bëhem burri edhe gruaja, mendimtari dhe tradhtari, i miri dhe i keqi, fëmija dhe plakur, qesh, qaj, zemërohem, indinjohem, frikësohem, entuziazmohem, dashuroj, çlirohëm. Arrita të hyja thellë në shpirtin e Hamza Hafizit për të kuptuar mënyrën e tij të të menduarit, për të njohur cilat ishin ato emocione që përmbytin shpirtin e tij, çfarë e shtynte drejt veprimeve të tij të neveritshme. Kur mbërrij në fund të të shkruarit të një libri, ndihem i dërrmuar, gati për t'u shembur përtokë. Deri në momentin që një libër i ri ma bën me sy dhe më fton në një udhëtim tjetër.

**– Zhanri juaj letrar janë kryesisht romanet historike? Përse keni zgjedhur pikërisht këtë lloj zhan-**

**ri dhe a vazhdon e lexohet po njësoj, me të njëjtin interes si më parë, nga lexuesit, romani historik? Përveç romaneve, ju keni shkruar edhe tregime dhe poezi. Ku e gjeni më shumë veten tuaj, tek poeti, romancieri apo tregimtari? Apo të gjitha nga pak?**

Në fakt ndihem i dashuruar pas fjalës së shkruar dhe i përkushtohem me pasion çdo gjëje me të cilën punoj. Në të gjithë librat e mi, lexuesi mund të dallojë edhe poezinë, të cilën e konsideroj se qëndron më lart se çdo lloj arti. Romani historik ma fitoi zemrën sepse tek ai mund të përdor çdo mënyrë të shprehur dhe mund të flas në masën që dëshiroj, për të djeshmen dhe të sotmen. Te ky roman unë zbuloj njeriun dhe rrugëtimin e tij në kohë. Sa i përket lexueshmërisë në Greqi, romani historik është një mënyrë të shkruar mjaft e përhapur.

**– Ç'mund të na thoni për krijimtarinë tuaj në proces apo në të ardhmen?**

Jam duke përfunduar një roman, ngjarjet e të cilit janë vendosur në periudhën e Ikonahisë – Betejës së Ikonave – në Bizant dhe ka si temë kryesore imazhin tonë nga ana e brendshme dhe nga ana e jashtme. Nëse gjithçka shkon mirë, pres të botohet në marsin e ardhshëm.

**– Cili është mjedisi ku ju preferoni të shkruani, orari kur shkruani. Për shembull Balzaku shkruante vetëm gjatë natës, në dhomën e tij dhe me një filxhan kafeje përpara. Po ju mund të na e përshkruani ambientin tuaj të punës, aty ku frymëzoheni?**

Unë punoj dhe shkruaj vetëm në zyrën time dhe gjithmonë natën, disa herë madje, deri në orën njëmbëdhjetë para dite. Kafja, një apo e shumta dy pije dhe cig-

arja janë ato që më shoqërojnë përherë. Ndërsa përpara se të filloj të shkruaj, domosdoshmërisht që do të lexoj poezi dhe do të dëgjoj muzikë orkestrale.

**– Nga e gjithë krijimtaria juaj, çfarë do të veçonit si më të veçantën dhe atë që ka lënë më shumë gjurmë në jetën tuaj? Këshilla më e mirë që mund t'u jepni të rinjve që duan të shkruajnë?**

Si më të veçantin do të cilësoja romanin tim të parë historik, "Imaret", i cili ndihmoi që të njihem gjerësisht nga publiku grek dhe përcaktoi shumëçka tek unë, përsa i përket eksperiencës së të shkruarit, por edhe hulumtimit. Ai ndikoi tek unë edhe nëpërmjet një prej personazheve të tij, myslimanit Ismail, atij plaku të urtë dhe stoik, të cilit përfiqem t'i ngaj, por pa ia arritur qëllimit, deri tani të paktën. Për humor, por kjo nuk do të thotë se nuk është e vërtetë, çdo libër që shkruaj, lë tek unë edhe një cen, trupor apo shpirtëror. Libri "Shenjtorë dhe demonë" më la me gumëzhitje të përhershme në kokë, "Guri prej qielli" më la me një aparat tretës nazeli, ndërsa "Serra", me ndihmën edhe të romanit që e pasoi, "Zemërimin", më bëri peshqesh tendinën në shpatull, për të cilën mu desh që të operohem për ta rikuperuar. Përsa u përket të rinjve që hedhin hapat e tyre të parë në letërsi, i ftoj që t'i bëjnë vetes triptikun e mëposhtëm të pyetjeve: A e adhurojnë kaq shumë të shkruarit sa të mund të jetojnë me bukë edhe djathë nëse nuk arrijnë suksesin? A mund ta shkruajnë edhe deri tri herë një tekst prej pesëqind faqesh pa e kopjuar tekstin fillestar, thjesht të konsultohen me të në lidhje me të dhënat faktike dhe elementët bazë? A munden t'i përkushtohen përditë punës, nga 10 deri në 15 orë, për një apo për dy vjet deri sa të mbarojnë një libër dhe kjo gjë që bëjnë të jetë tërheqëse për ta? Nëse u përgjigjen pozitivisht këtyre tri pyetjeve, atëherë le të ecin përpara dhe të jenë të sigurt se munda i tyre nuk do të shkojë dëm.

**– Çfarë keni lexuar nga letërsia shqipe? Keni ndonjë shkrimtar të preferuar?**

Fatkeqësisht për mua, kam lexuar vetëm "Pallati i Ëndrrave" të Ismail Kadaresë, i cili më bëri përshtypje të madhe atëherë në vitet rinore. Ishte një libër referimi për ecurinë time. Ndërkaq, i kam vënë si objektivet që të lexoj të paktën katër shkrimtarë shqiptarë të tjerë gjatë gjashtëmujorit të ardhshëm. /gsh.al



| <b>EPOKA E RE</b><br>Autor: GAZMEND MORINA                           |  | AKTORI AMERIKAN STILLER                       | JURIST QË JEP NDIHMË E KËSHILLA PËR ÇËSHITJE TË DREJTËSISË   | JEVG   | IVAN KLASNIÇ                                      | KËNGËTARJA ANGLEZE TANITA                | ▼   | KRYENGRITËSI QË DILTE MALIT E LUFTONTE MINDERI I ULËT (vjet.) | IVREA  | <b>EPOKA E RE</b><br>BIMË SHUMËVJEÇARE ME TRUNG TË TRASHË | LLOJ BIME NARKOTIKE                |
|--|--|---|--|--|---|--|---|---|--|---|------------------------------------|
| ZËRI I BURRIT NDËRMJET TENORIT DHE BASIT                             |  |   |  |  |   |  |   |   |  | DY BASHKËTINGËLLORE DRAMË E SANTORIT                      |                                    |
| NGJALLJA E KUJTIMEVE PËR DIKË  |  |   |  |  |   |  |   |   | EPOKË (shq.)   |   |                                    |
| KANUN, LIGJ (vjet.)  |  |   |  |  | AKTROJA AMERIKANE BASINGER SHTET I MADH NË AZI    |  |   |   | SEKRETARI I OKB-së BAN KI QË ËSHTË LARA-LARA NË TRUP (për kafshët) |   |                                    |
| <b>EPOKA E RE</b><br>BASHKËT. SHPREHET ME FJALË                      |  |   |  | GJAKATARI BIXHOZ                             |   |  |   |   |  | ZANORE MALI MË I LARTË NË TURQI                           |                                    |
| NJERI I VARFËR QË ËSHTË PËR T'U MËSHIRUAR (shq.)                     |  |   |  |  |   |  |   | BANORI I ARABISË SAUDITE VARGU I KURANIT                      |  |   |                                    |
| KËNGËTARJA ..... SEJDIU ZANORE                                       |  |   | NËNA VEPRIMTARI ZEZAK MARTIN ..... KING                      |  |   |  | BUJKU KËNGËTARJA BERISHA                          |   |  | ANTIGONA SEJDIU OLIVIER MARTINEZ                          |                                    |
| <b>EPOKA E RE</b><br>DIÇKA QË BURON NGA DIÇKA TJETËR                 |  | I SPËRKATA ME UJË                             | BOKSIERI I NJOHUR KLITSCHKO                                  | "Z" në mes të dy "A"                         | PAKTI USHTARAK MË I MADH NË BOTË                  | TEXAS LIBRARY ASSOCIATION IDRIZ BALAJ    |   | REGJISORI ... QOSJA   | TËRËSIA E ORENDIVE SMIRA   |   |                                    |
| KANAPE E GJERË DHE E GJATË SI SHTRAT (shq.)                          |  |   |  |  |   |  | PËRGËZIMET SHTET (FR.)                            |   |  | MIMOZA AHMETI AKTORJA ..... AJETI                         | AKTORJA ME FAMË BOTËRORE ... FARIS |
| AKTORJA E FAMSHME AMERIKANE NË FOTO ..... OLSEN (shqip.)             |  |   |  |  |   |  |   | KËNGËTARI ..... ARIFI ENË E METALTË PËR TË SKUQUR VAJIN       |  | TONI ADAMS QYTET I SHENJTË I MYSLIMANËVE                  |                                    |
| KËSTET BANKARE PËR KTHIMIN E KREDISË                                 |  |   |  |  |   | GRADE USHTARAKE QË KA TË BËJË ME FSHATIN |   |   | REGJISORI ... HALILI PUNËTOR I TEATRIT TË KUKULLAVE                |   |                                    |
| KËNGËTARJA ..... SEJDIU ZANORE                                       |  |   |  | KOHA E NDARË PËR PUNË POLITIKANI FERID ..... |   |  |   | JETËSHKRIM ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ SHEARER (origj.)            |  | ARMENIA UNITED PROGRESIVE ALLIANCE                        |                                    |
| SHIU I IMËT DALLGA   |  |   |  |  | UMA TURMAN AKTORI EGJIPTIAN .... SHARIF           |  |   | BISHTUK ME VAJGURI (shq.) QË KA MBUSHUR NJË VIT, MOTAK        |  |   | PRAPË                              |
| ARTANA   |  | ISH MUZIKANTI RUS STRAVINSKI GDHENDUR, LATUAR |  |  |   |  | PYLLI PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT (pashq.) |   | I ÇELA ISH AKTORJA AMERIKANE GARDNER                               |   |                                    |
| DY BASHKËTINGËLLORE  |  |   | FEMRA LUFTËTARE QË NUK MARTOHEJ (mit greke) PORËSIA E FUNDIT |  |   |  |   | MA JEP INSTITUCION I LARTË SHKENCOR                           |  | AGIM POSHKA KALI I SHALES                                 |                                    |
| <b>EPOKA E RE</b><br>HENDEK PËR TË UJITUR (sh.shq.) LLOJ SHALE DRURI |  |   |  |  |   |  |   |   |  |   | ZANORE ALBANOLOGIA DURHAM          |
| FUTBOLLISTI FRANCEZ ..... NASRI (MANCHESTER CITY)                    |  |   |  |  |   | SHEGË LUMË NË SHQIPËRI                   |   |   |  |   |                                    |
| ALUMIN, AMPER  |  |   |  | KLUBI FUTBOLLI NË GREQI                      | PAJISJA E VETURËS SË LËSHON TINGUJ REOMIR, INDIUM |  |   |   | OSAKA RROGË VJETORE E PAPËS  | IVAN DIXON QË I PËRKET ETIKËS                             | BALTA E QULLËT, GJANA              |
| KULLË E XHAMISË  |  |   |  |  |   |  | SHKRIMTARI ISMAIL STUDENT AID REPORT              |   |  | IGLESIA GABRIEL NJËSI E VJETËR PESHE                      |                                    |
| ZBRITJE E AEROPLANIT NË TOKË   |  |   |  |  |   |  | ELEMENTI KIMIK (SE)                               |   | FUTBOLLISTI FRANCEZ (ROMA) TITAN                                   |   |                                    |
| PUNA E PËRDITSHME, ZAKONISHT E MËRZITSHME, PA ASNJË NDRYSHIM         |  |   |  |  |   |  | ATEMOR, JO TEMATIK ZANORE                         |   |  |   | BASHKËT. KRUIJA                    |
| REGJISORJA ..... ELEZI   |  |   |  | HIJESHI, BUKURI QË TË BËN PËR VETE           |   |  |   | LIQEN I MADH NË AMERIKËN JUGORE                               |  |   |                                    |

# LAKRA E KUQE - TRI HERË MË ME VLERË SE E BARDHA

I thonë Lakra e Kuqe, por në të vërtetë ngjyra e saj është një vjollcë e thellë e ndezur, shija e së cilës të befason qiellzën.

Lakra e kuqe është pjesë e tryezës sonë, jo vetëm për festa. Nëse mendoni që lakra e kuqe me lakrën e bardhë ndryshojnë vetëm nga ngjyra, ta dini se gaboheni rëndë.

Lakra e kuqe është nga ato perime që është e shijshme kur hahet e gjallë ose e gatuar.

Lakrën e kuqe mund ta hamë në sallata, mund ta gatujmë më avull apo ta përziejmë në një pjatë me perime të tjera.

Fibra që gjendet tek lakra e kuqe njihet për punën e shkëlqyer në parandalimin e konstipacionit dhe rregullimin e sistemit tretës.

Lexoni më poshtë nga AgroWeb.org, listën e përfitimeve fantastike që merrni nga lakra e kuqe, e cila kultivohet me sukses në shumë rajone të Shqipërisë.

## Lakra e kuqe apo Lakra e bardhë?

Të dyja lakrat janë të mira për shëndetin e njeriut, por lakra e kuqe është më e fuqishme në aspektin shëndetësor.

Lakra e kuqe përmban 85% të dozës ditore të vitaminës C, ndërsa lakra e bardhë ka vetëm 47 përqind.

Besoje ose jo, lakra e kuqe ka më shumë Vitaminë C se sa portokallet.

Për më tepër, lakra e kuqe është nga ato të pakta perime me

nivelin më të ulët të mbetjeve të pesticideve në lëkurën e saj.

Lakra e kuqe ka 10 herë më shumë vitaminë A se lakra e bardhë. Kjo e fundit ka dy herë më shumë vitaminë K se sa lakra e kuqe.

Kur vjen puna tek hekuri, lakra e kuqe ka dyfishin në krahasim me lakrën e bardhë. Sa i përket antioksidantëve, lakra e kuqe është triumfatore dhe superiore.

## Fuqi shtesë për sistemin imunitar

Lakra e kuqe është e pasur me vitaminën C, një antioksidant i rëndësishëm për sistemin tonë imunitar.

Ajo stimulon qelizat e bardha duke krijuar një sistem të fortë mbrojtës në organizmin tonë.

Sistemi imunitar është jashtëzakonisht i ndjeshëm ndaj raportit të oksidantëve dhe antioksidantëve, duke qenë se prodhimi i pakontrolluar i radikaleve të lira, mund të dëmtojë sistemet e

mbrojtjes.

Radikalet e lira prodhohen në trup dhe dëmtojnë qelizat. Antioksidantët janë mekanizmat më të mirë mbrojtës dhe përzënë nga trupi të gjithë qelizat e dëmshme.

Lakra e kuqe ka aq shumë vitamin C sa që është një nga ushqimet me nivel më të lartë antioksidantësh në të gjithë zinxhirin ushqimor.

## Lufton inflamacionet dhe artritin

Lakra e kuqe ka elementë të rëndësishëm që luftojnë inflamacionin. Shkencëtarët kanë provuar që konsumimi i lakrës së kuqe ka një efekt pozitiv në reduktimin e enjtjeve.

Inflamacioni mund të shkaktojë dhimbje dhe ënjtje në kyce dhe gjymtyrë, ndaj një dietë e pasur me fruta dhe perime përfshirë lakrën e kuqe është e nevojshme. Ushqime të tilla anti inflamatore janë kura më natyrale në betejën



kundër artritit dhe komplikacioneve që vijnë prej tij.

## Ul rrezikun e osteoporozës, sëmundjes së kockave

Lakra e kuqe është e pasur me vitaminën K. A e dinit që vitamina K rrit masën e një proteine specifike të nevojshme për ruajtjen e kalciumit në kocka, duke ulur kështu rrezikun e osteoporozës?

Disa studime mbi përfitimet e vitaminës K kanë zbuluar që marrja në sasi të mëdha të kësaj vitamine ndalon gërryerjen e kockave tek njerëzit që janë të diagnostikuar me osteoporozë.

Masa kockore e njeriut formohet gjatë njëzet viteve të para të njeriut. Ajo vazhdon të qëndrojë e plotë në mënyrë konstante deri në moshën 40 vjeçare.

Masa kockore tek gratë reduktohet pas menopauzës dhe vazhdon të bjerë ndjeshëm deri në moshën 70 vjeçare. Ky proces rrit rrezikun e

frakturave të kockave.

Prandaj kockat duhen ruajtur me kujdes dhe vitamina K është e nevojshme për të vonuar dhe parandaluar gërryerjen e kockave.

## Lufton sëmundjet kronike

Sëmundjet kronike si Alzheimeri, Huntington, Parkinson etj prekin 45 milionë njerëz në botën duke dëmton qelizat e trurit në mënyrë progresive deri në shkatërrimin e tyre.

Lakra e kuqe ka antioksidantë të pasur që parandalojnë ose kthejnë mbrapsht dëmtimet në ADN.

## Mbron stomakun

Ushqimet probiotike i japin sistemit tonë tretës një dozë të mirë bakteresh të nevojshme. Këto baktere krijohen në kombinimin e duhur të lakrës së kuqe, kripës dhe gjatë procesit të fermentimit. /AgroWeb.org



# SI T'I PËRDORNI GJETHET E DAFINËS PËR GRIPIN DHE TË FTOHURËN

Dafina është një bimë shumë e pasur me vitamina dhe minerale.

Ajo është mjaft e dobishme për shëndetin e organizmit dhe ofron lehtësim nga shumë probleme, sidomos ato që prekin rrugët e frymëmarrjes.

Nëse ju vuani nga këto probleme, më poshtë do të mësoni nga AgroWeb.org përgatitjen e disa kurave me dafinë që do të përmirësojnë ndjeshëm simptomat prej të cilave vuani.

## Kura aromatike me dafinë kundër gripit, bllokimeve dhe sekrecioneve

Kura me avullin e lëshuar nga dafina i hap rrugët e frymëmarrjes dhe zhblokon hundët.

Ekspertet rekomandojnë zierjen e 6 gjetheve të dafinës në dy gota me ujë.

Pasi uji të ketë marrë valë, hiqeni

nga zjarri dhe hidheni në një enë tjetër.

Mbulojeni kokën me peshqir dhe mbajeni fytyrën pranë enës. Merrni frymë thellë duke nuhatur aromën e këndshme të dafinës.

## Shurup kolle i përgatitur në shtëpi

Dafina përbën një mënyrë efektive për të trajtuar kollën e thatë.

Kura kundër kësaj kolle përgatitet shumë lehtë në kushtet e shtëpisë.

Në një tenxhere ose çajnik AgroWeb.org ju udhëzon që të hidhni dy gota me ujë dhe më pas 6 gjethe dafine.

Pasi të kenë zier për 15 minuta, kullojeni lëngun dhe lëreni të ftohet.

Lëngun hidheni në një tas qelqi dhe shtoni gjashtë lugë gjelle me

sheqer kaf dhe lëngun e një limoni.

Përziejini mirë përbërësit me njëri tjetrin dhe lëngun futeni në një kavanoz me kapak, të cilin mund ta ruani në frigorifer për 7 ditë.

## Kompresat me gjethe dafine

Gjethet e dafinës janë shumë të mira kundër bronshitit.

Me to ju mund të bëni kompresë të mira e shëruese.

Në një tenxhere të vogël hidhni dy gota me ujë dhe pasi të kenë marrë valë shtoni 3 gjethe dafine.

Fikeni sobën dhe pas pak minutash, në tenxhere hidhni një napë të cilën më pas mund ta përdorni si kompresë e ta mbani në kraharor.

Një mënyrë tjetër është që pasi gjethet e dafinës të kenë qëndru-



ar në ujë të ngrohtë për disa minuta, t'i vendosni menjëherë mbi kraharor.

## Vaji esencial i dafinës

Aroma e thellë e dafinës ju ndihmon të merrni frymë lirisht. Për përgatitjen e vajit të dafinës ju

duhen 4-5 gjethe dafine dhe 2 gota me vaj bajameje të ëmbël.

Pastrojini gjethet dhe hidhni në një kavanoz bashkë me vajin e bajames.

Lëri në bashku për 40 ditë dhe më pas mund ta përdorni vajin për të përmirësuar frymëmarrjen ose kundër sinozitit. /AgroWeb.org

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

## 'Dardanët' duan fitore në ndeshjen më të rëndësishme

Kosova po synon ta fitojë ndeshjen më të rëndësishme në historinë e saj dhe në këtë mënyrë ta sigurojë me një këmbë kualifikimin në Kampionatin Evropian "Euro 2020". Trajneri Bernard Challandes ka thënë se për ta arritur këtë sukses "dardanëve" u duhet një paraqitje e përkryer ndaj çekëve. "E kemi një mundësi dhe mund ta arrijmë kualifikimin, por duhet ta bëjmë një lojë të përkryer, të jashtëzakonshme ndaj një kundërshtari mjaft të fuqishëm", ka thënë Challandes



në Grupin A me 12 pikë, kurse Kosova është një pozitë më poshtë me 11 pikë. E para e grupit është Anglia me 15 pikë.

**Muriqi: Ndiej keqardhje që nuk mund të jem përkrah shokëve**

Sulmuesi kryesor i Kosovës, Vedat Muriqi, nuk mund t'i ndihmojë "dardanët" në ndeshjen kundër Çekisë në kuadër të kualifikimeve për "Euro 2020". Ai ka thënë se ndien keqardhje që nuk mund të jetë përkrah bashkëlojtarëve në këtë ndeshje shumë të rëndësishme për Kosovën. "U uroj sukses të gjithë shokëve të mi për ndeshjen! Njëherësh, ndiej keqardhje që nuk do të mund të jap mund në fushë bashkë me ta në këtë përballje të rëndësishme. Përkrahje e plotë, përherë", ka shkruar Muriqi në profilin e vet në "Facebook".

**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 13 NËNTOR** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll sonte (e enjte) zhvillon ndeshjen më të rëndësishme në histori të saj, kurse kundërshtare do të ketë Kombëtaren e Çekisë. Ndeshja në mes të dy skuadrave përfaqësuese zhvillohet nga ora 20:45 në "Doosan Arena" në qytetin e Plzenit. Përzgjedhësi i Kosovës, Bernard Challandes, ka thënë se në fillim të kualifikimeve "dardanët" ishin të fundit, por që tash janë shumë afër kualifikimit në Kampionatin Evropian. "E dimë saktë se kush jemi ne dhe kush është Çekia. Gjatë shortit e dinim se e para ishte Anglia, pastaj Çekia, Bullgaria dhe Mali i Zi, kurse

Kosova ishte e fundit. Ne nuk ndihemi në presion, e vlerësojmë faktin se kemi arritur deri këtu. E dimë se na pret një lojë ngazëluese dhe kjo është një situatë e mrekullueshme për ne. E kemi një mundësi dhe mund ta arrijmë kualifikimin, por duhet ta bëjmë një lojë të përkryer, të jashtëzakonshme ndaj një kundërshtari mjaft të fuqishëm", ka thënë Challandes, i cili e ka komentuar edhe mungesën e Vedat Muriqit. "Mungesa e Muriqit është e madhe dhe nuk kemi lojtar që do të mund ta zëvendësojë atë. Por ne duhet të përgjigemi si ekip ashtu siç kemi bërë çdoherë deri më tani kur kemi pasur mungesa", ka shtuar trajneri zviceran. Krahas Challandesit në konferencë për medie i pranishëm ishte edhe Valon Berisha. Futbollisti i

skuadrës së Lazios në Itali ka thënë se "dardanët" e kanë synim fitoren në ndeshjen ndaj çekëve, ani pse kundërshtari ka një ekip të fortë. "Kemi ardhur këtu të fitojmë, ta realizojmë një ëndërr që e kemi. Çekia është e fortë, ka ekip të mirë, por ne jemi gati për këtë 'luftë', pasi do të jetë një luftë si për ne, po ashtu edhe për ta. Kjo është ndeshja më e rëndësishme si kombëtare që e kemi luajtur deri më tani", ka thënë Berisha dhe ka shtuar: "Humbje e madhe është mungesa e Vedat Muriqit. Për atë se a luaj unë nga minuta e parë, vendos trajneri. Përgatitjet kanë shkuar mirë. Jemi të gatshëm ta japim më të mirën për të arritur fitore".

Për ndeshjen ndaj Kosovës foli trajneri i Çekisë, Jaroslav Shilhavy, i cili ka thënë se humbja kundër "dardanëve" është e papranueshme për çekët. "Ne nuk pranojmë që të humbasim", ka thënë fillimisht ai. "Nuk kemi nevojë për motivim, pasi të gjithë e dinë rëndësinë që ka ndeshja për ne. Gabimet që i kemi bërë në ndeshjen e parë nuk besoj se do t'i përsërisim. Nëse nuk fitojmë do të shkonte huq e gjithë puna që kemi bërë. Besoj te lojtarët dhe te të gjithë që janë afër nesh. Na kanë mbetur disa bileta pa shitur dhe besoj se do të shiten dhe do ta kemi përkrahjen e madhe të tifozëve", ka deklaruar Shilhavy. Çekia renditet në pozitën e dytë

| GRUPI A                 |      |    |
|-------------------------|------|----|
| 20:45 Çeki - Kosovë     |      |    |
| 20:45 Angli - Mali i Zi |      |    |
| Tabela                  |      |    |
|                         | PIKË |    |
| 1. Anglia               | 6    | 15 |
| 2. Çekia                | 6    | 12 |
| 3. Kosova               | 6    | 11 |
| 4. Mali i Zi            | 6    | 3  |
| 5. Bullgaria            | 6    | 3  |

## Prokuroria fillon hetimet për biletat e ndeshjes Kosovë - Angli



**PRISHTINË, 13 NËNTOR** - Prokurori i Shtetit njofton opinionin publik se ka autorizuar njësitet përkatëse të Policisë së Kosovës në mënyrë që të verifikohen dyshimet e ngritura si dhe për grumbullimin e të gjitha informatave lidhur me shitjen e biletave online për ndeshjen e futbollit

ndërmjet Kosovës dhe Anglisë. Në një komunikatë për media thuhet se Prokuroria e Shtetit ka filluar hetimet që nga 15 tetori 2019 lidhur me shitjen e biletave online për ndeshjen Kosovë-Mali i Zi, për të cilën është njoftuar opinionin publik dhe se tashmë hetimet janë duke vazhduar. Edhe të

mërkurën sistemi për blerjen e biletave online për ndeshjen Angli - Kosovë ishte jashtë funksionit. Në fakt, faqja ka rënë nga sistemi ende pa nisur shitja e biletave, që ishte caktuar për ditën e martë. Kjo mënyrë e shitjes së biletave është kritikuar nga tifozët, pasi ata e kanë të pamundur t'i blejnë ato.

## Kosova U19 barazon kundër Ruisë U19

**PRISHTINË, 13 NËNTOR** - Përfaqësuesja e Kosovës U19 i ka nisur me barazim kualifikimet për Kampionatin Evropian "Irlanda e Veriut 2020" që po mbahen në Uells në kuadër të Grupit 5. "Dardanët" e drejtuar nga Ramiz Krasniqi kanë barazuar me Rusinë, me rezultat 1-1, në një

ndeshje mjaft të fortë dhe me angazhim maksimal të të dyja palëve. Kosova kaloi e para në epërsi në minutën e 11-të, kur Adonis Aliu shënoi një gol me mjeshtëri me parabolë në përballje me portierin rus. Megjithatë, gëzimi i "dardanëve" zgjati vetëm një minutë pasi rusët, pas një

aksioni nga krahu i djathtë, arritën t'i barazojnë shifrat me golin e Igor Shkolik. Në ndeshjen tjetër të këtij grupi Uellsit e mposhti Poloninë me rezultat bindës 3-0. Ndeshjen e dytë Kosova U19 e zhvillon kundër Polonisë, më 16 nëntor, kurse ndeshjen e fundit kundër Uellsit, më 19 nëntor.



## Greza i kundërpërgjigjet Rejes: Jam i gatshëm ta përfaqësoj popullin tim

TIRANË, 13 NËNTOR - Trajneri i Shqipërisë, Edy Reja, ka konfirmuar se Eros Greza e ka refuzuar ftesën e kombëtares kuqezi. "Më vjen keq për Grezdën, është lojtar me potencial, vendosi të mos pranohet ftesën. Askush nuk është

Mesi dhe Shqipëria mbi të gjitha", ka thënë trajneri italian. Mirëpo nuk ka vonuar shumë dhe ka ardhur kundërpërgjigja e futbollistit shqiptar. Futbollisti nga Kosova ka thënë se gjithmonë është i gatshëm ta përfaqësojë

Shqipërinë. "Për korrektësi dhe për informimin e saktë të të gjithë tifozëve, me duhet t'i sqaroj polemikat e krijuara rreth emrit tim. Për grumbullimin e tanishëm për dy ndeshjet e radhës unë s'kam marr asnjë ftesë zyrtare ose

ndonjë telefonatë nga federata apo trajneri i kombëtares. Sa më përket mua personalisht, kam qenë, jam dhe do të jem gjithmonë i gatshëm ta përfaqësoj popullin tim dhe t'i mbroj ngjyrat kuq e zi", ka thënë Greza.



## Shqipëria kërkon fitore ndaj Andorrës

TIRANË, 13 NËNTOR - Kombëtarja e Shqipërisë sonte (e enjte) zhvillon ndeshjen kualifikuese për Kampionatin Evropian "Euro 2020" kundër Andorrës. Kjo ndeshje do të zhvillohet në "Elbasan Arena", kurse kapiteni Elseid Hysaj ka thënë se Shqipëria synon fitore ndaj Andorrës në mënyrë që të presë sa më e relaksuar përballjen e rëndësishme ndaj kampionëve të botës, Francës. "Fillimisht po mendojmë për Andorrën, pasi është ndeshja e parë për ne në këtë muaj, pastaj vjen Franca. Natyrisht, ndeshja e dytë është më vështirë. Megjithatë, ndaj Francës do të kemi një stadium të mbushur plot, do të jemi më afër me tifozët", ka thënë Hysaj, i cili ka konfirmuar se ndihet mirë pas dëmtimit që kishte pësuar kohë më parë. "Para së gjithash duhet të fitojmë me Andorrën, që të shkojmë me psikologjinë e duhur ndaj kampionëve të botës. Synimi është që të grumbullojmë sa më shumë pikë në këto eliminatore dhe të vendosim rekord në këtë drejtim. Franca



dihet se cila është, do ta kemi shumë të vështirë", ka shtuar Hysaj.

Mbrojtësi kuqezi bëri me dije se ndaj Andorrës, Shqipëria do të luajë sikurse ndaj Moldavisë. "Duhet të sulmojmë dhe të përpiqemi të mos të pësojmë gol. Mbi të gjitha, duhet të jemi të qetë me kalimin e minutave, nëse rezultati nuk zhbllkohet", ka përfunduar Hysaj.

Ndeshja Shqipëri - Andorre fillon në orën 20:45.

### GRUPI H

18:00 Turqi - Islandë  
20:45 Shqipëri - Andorrë  
20:45 Francë - Moldavi

### Tabela

|              |   | PIKË |
|--------------|---|------|
| 1. Turqia    | 8 | 19   |
| 2. Franca    | 8 | 19   |
| 3. Islanda   | 8 | 15   |
| 4. Shqipëria | 8 | 12   |
| 5. Andorra   | 8 | 3    |
| 6. Moldavia  | 8 | 3    |

## Fitojnë lakersat dhe Miami

PHOENIX, 13 NËNTOR - Pas një loje me rivalitet dhe emocione, lakersat fituan me rezultat 123-115 ndaj Phoenixit, ndeshje që u vendos në minutat e fundit në favor të ekipit kalifornian. Edhe pse kolektiviteti i ekipit të Phoenixit ishte në lartësinë e duhur (6 lojtarë shënuan mbi 11 pikë), kjo nuk mjaftoi. Për lakersat u dalluan Davisi me 24 pikë e 12 rebounde, Kuzma me 23 pikë e LeBron Jamesi me 19 pikë e 11 asistime. Mirë u paraqit edhe skuadra e Sacramentos, që mposhti 107-99 Portlandin, ndeshje me dy pamje. Mysafirët dominuan në pjesën e parë (Lillard 27 pikë), por në të dytën erdhi përmbysja e vendësve, ku u dallua Bogdanoviç me 25 pikë e 10 asistime, raporton "Telesport". Skuadra e Atlantës arriti një fitore të rëndësishme ndaj Denverit me shifrat 125-121, duke korrur suksesin e katërt sezonal. Dallimin e bëri Trae Young, që realizoi 42 pikë e 11 asistime. Vijnë momenti i mirë i skuadrës së Utah Jazzit, që korri fitoren e tetë sezonale. Jazz



### REZULTATET

|                          |         |
|--------------------------|---------|
| Indiana - Oklahoma       | 111-85  |
| Philadelphia - Cleveland | 98-97   |
| Miami - Detroit          | 117-108 |
| Chicago - New York       | 120-102 |
| Denver - Atlanta         | 121-125 |
| Phoenix - Lakers         | 115-123 |
| Utah Jazz - Brooklyn     | 119-114 |
| Sacramento - Portland    | 107-99  |

mposhti 119-114 Brooklynin, duke përmbysur një disavantazh prej 15 pikësh në minutat e fundit (Mitchell 30 pikë). Miami Heat, falë 20 pikëve të Butlerit dhe Nunnit, mposhti 117-108 Detroitin, ndërsa Philadelphia triumfoi në sekondat e fundit 98-97 ndaj Clevelandit (Embiid 27 pikë e 16 rebounde).

### SHKURT

#### Vieira: Xhaka meriton më shumë respekt

Ish-kapiteni i Arsenalit, Patrick Vieira, ka thënë se mesfushori Granit Xhaka meriton më shumë respekt. Futbollistit shqiptari nuk ka luajtur në fanellën e "topçinjve" që nga incidenti në ndeshjen kundër Crystal Palace dhe ka humbur shiritin e kapitenit. "Ndihej keq sepse ishte kapiteni dhe po kalon kohë të vështirë në Arsenal. Mendoj se duhet të kujtojmë se ka arritur shumë që nga transferimi në Arsenal dhe meriton më shumë respekt. Kur je lojtar dhe nuk luan si dëshiron, nuk je i kënaqur me vetën. Ndonjëherë thua gjëra që pendohesh. Është e vështirë sepse ish-lojtarët kanë thënë fjalë të këqija për të. E di sa i mirë është dhe do ta kalojë këtë gjë sepse ka karakter të fortë", ka thënë Vieira.

#### 'El Clasico' zhvillohet më 18 dhjetor

"El Clasico" e parë e sezonit në mes të Barcelonës dhe Real Madridit është dashur të zhvillohej më 26 tetor, por kjo ndeshje u shty për 18 dhjetor për shkak të protestave. "El Clasico" zhvillohet muajin tjetër në "Camp Nou" dhe fillon në orën 20:00.

#### Bayerni planifikon rikthimin e Guardiols

Kampioni i Gjermanisë, Bayern Munchen, vazhdon të jetë në kërkim të trajnerit të ri pasi pak kohë më parë e shkarkoi Niko Kovaçin. "Bild" ka raportuar të mërkurën se Bayerni po planifikon rikthimin e Pep Guardiols, i cili aktualisht e drejton skuadrën e Manchester Cityt. Tekniku spanjoll mund të largohet nga klubi anglez në fund të sezonit dhe rikthimi në Bayern duket i mundshëm. Në opsion të gjigantëve gjermanë janë edhe Mauricio Pochettino, Massimiliano Allegri dhe Jose Mourinho.

#### Kloppi: Është vetëm fillimi

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, ka thënë se është i gëzuar me fillimin e këtij sezoni. "Reds" mposhti Cityn në ndeshjen e fundit me rezultat 3-1 dhe hyn në pushimin ndërkombëtar të pamposhtur në kampionatin anglez. Tekniku gjerman ka thënë se është i gëzuar që ka arritur të bëjë këtë gjë dhe beson se do ta vazhdojë këtë formë. "Është vetëm fillimi, të gjithë e dinë këtë gjë. Nëse do të mendoja se do të kishim 34 pikë, nuk do ta besoja. Djemtë janë në pushimin ndërkombëtar. Duhet të rikthehen në formën e duhur. E patë sa e vështirë ishte ndeshja ndaj Cityt. Shpresojmë se do të rikthehen mirë dhe pastaj do të luajmë ndaj Crystal Palace", deklaroi ai. Liverpooli është në vendin e parë në tabelë me 34 pikë, tetë më shumë se Leicester City që renditet në vendin e dytë.

#### Rakitiqi sulmon Barçën: Jam i trishtuar

Ivan Rakitiqi ndihet sikur Barcelona "mori topin tim" pasi nuk po ka minutazh këtë sezon. Një interpretues me ndikim që kur u bashkua me Barçën para fitimit të tripletës 2014/15, Rakitiqi ka ngrohur stolin që pas ardhjes së holandezit Frenkie de Jong në verë. Mesfushori kroat ka nisur vetëm në njërin nga shtatë paraqitjet e tij në La Liga. I pyetur në lidhje me gjendjen e tij të vështirë në një intervistë për Universo Valdano në Movistar, Rakitiqi u përgjigj: "Si mund ta shijoj? Është sikur të kam thënë shumë herë, si ndihet vajza ime e vogël kur merr një lodër prej saj? Ajo ndihet e trishtuar. Epo, unë ndihem njësoj. Ata morën topin tim. Ndihej i trishtuar", ka thënë Rakitiqi.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)  
 Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)  
 Agencija za Investicije i Podršku Preduzeća na Kosovu (KIESA)

Me qëllim të promovimit të kompanive prodhuese të kosovare në gjetjen e tregjeve të huaja për eksport, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpallë:

**Thirrje publike për aplikim për pjesëmarrje në shtandin shtetëror të Kosovës në panairin e produkteve ushqimore "Green Week 2020" në Berlin të Gjermanisë më 17-26 janar 2020**

Paraqitja shtetërore organizohet nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përkatësisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë KIESA, e cila mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e shtandit, regjistrimin e dhjetë (10) subjekteve pjesëmarrëse, shpenzimet e energjisë elektrike, pastrimin ditor, etj., ndërsa shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dërgimit e materialëve promovues, etj. të subjekteve pjesëmarrëse do të merren përsipër nga vet subjektet pjesëmarrëse.

Ju lutem vini re se vetëm shprehjet e interesimit të dërguara deri më datë 28.11.2019 dhe vetëm aplikacionet e plotësuar tërësisht mund të konsiderohen për vlerësim.

- Për të aplikuar duhet dorëzuar:
  - Aplikacionin e plotësuar më të dhënat bazike të subjektit aplikues; dhe
  - Dokumentet e kërkuara.
- Dokumentet e domosdoshme për aplikim:
  - Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
  - Dëshminë e xhirrologarisë aktive në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
  - Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
  - Vërtetimin nga Gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime (kërkohet origjinali, jo me i vjetër se 30 ditë).
  - Deklaratën nën betim;
  - Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2018 nga Administrata Tatimore e Kosovës; dhe
  - Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj.

Ju lutem vini re se në mungesë të cilitdo dokument të kërkuar në listën e mësipërme aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet dhe nuk do të shqyrtohet tutje për kriteret e veçanta të listuara më poshtë.

- Dhjetë (10) subjektet pjesëmarrëse do të përzgjidhen sipas kriterëve të veçanta në vijim dhe rangimit të pikëve:
  - Produktet që subjekti aplikues do të ju ofrojë blerësve potencial në panair, maksimum dhjetë (10) pikë: një (1) pikë për një (1) produkt, tre (3) pikë për dy produkte, pesë (5) pikë për tri (3) produkte, shtatë (7) pikë për katër (4) produkte dhe dhjetë (10) pikë për pesë (5) e më shumë produkte;
  - Njohuria e gjuhëve të huaja dhe aftësi prezantuese të përfaqësuesve të subjektit aplikues, maksimum dhjetë (10) pikë kumulative: gjuha Angleze pesë (5) pikë, gjuha Gjermane katër (4) pikë dhe gjuhët tjera një (1) pikë;
  - Materiale promovuese të subjektit aplikues në gjuhët e huaja, maksimum dhjetë (10) pikë kumulative: në gjuhën Angleze katër (4) pikë, në gjuhën Gjermane katër (4) pikë dhe dy (2) pikë në gjuhët tjera evropiane;
  - Shtetet ku janë eksportuar produktet e subjektit aplikues gjatë viteve 2018 dhe 2019, maksimum dhjetë (10) pikë kumulative: shtetet anëtare të BE-së pesë (5) pikë, shtetet e Ballkanit Perëndimor që nuk janë anëtare të BE-së (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia) tri (3) pikë dhe tregjet e tjera dy (2) pikë;
  - Certifikimi ndërkombëtar i subjektit aplikues, maksimum pesë (5) pikë kumulative: HACCP dy (2) pikë, ISO 22000 dy (2) pikë dhe certifikim tjetër relevant një (1) pikë;
  - Paraqitja e subjektit aplikues në panair tri (3) vitet e fundit, maksimum pesë (5) pikë: një panair një (1) pikë, dy (2) panair dy (2) pikë, tri (3) panair tri (3) pikë, katër (4) panair katër (4) pikë dhe pesë (5) e më shumë panair pesë (5) pikë; dhe
  - Qarkullimi vjetor i subjektit aplikues gjatë vitit fiskal 2018, maksimumi dhjetë (10) pikë: nga zero deri në 500.000 euro katër (4) pikë; nga 500.001 deri në 1.000.000 euro tetë (8) pikë dhe mbi 1.000.000 euro dhjetë (10) pikë;

Më 25.11.2019, në ora 14:00, në sallën e takimeve të KIESA-s, zyrtarët e KIESA-s do të përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe për mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair. Subjektet që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në këtë takim.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë atë më së largu deri më 28.11.2019 në zyrën e Arkivit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, rruga Muharrem Fejza, p.n. Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës.

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informimi dhe pyetësi për shprehje të interesit mund të merren në KIESA-MTI apo të shkarkohen nga faqet e internetit mtj.rks-gov.net dhe kiesa.rks-gov.net apo në e-mail adresën export.kiesa@rks-gov.net.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)  
 Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)  
 Agencija za Investicije i Podršku Preduzeća na Kosovu (KIESA)

U cilju promovisanja proizvođačkih kompanija na Kosovu u pronalazenju stranih tržišta za izvoz, Ministarstvo Trgovine i Industrije preko Agencije za Investicije i Podršku Preduzećima na Kosovu (KIESA) objavljuje:

**Javni poziv za apliciranje za učešće na državnom štandu Kosova na sajmu prehrambenih proizvoda "Green Week 2020" Berlinu u Nemačkoj**

**17-26 januara 2020**

Državna prezentacija se organizuje od strane Ministarstva Trgovine i Industrije, odnosno Kosovske Agencije za Investicije i Podršku Preduzećima KIESA koja pokriva troškove izložbenog prostora, izgradnju štanda, registraciju deset (10) učesnika, troškove električne energije, svakodnevno čišćenje, itd., dok će troškovi putovanja, smeštaja, hrane, isporuke promotivnog materijala itd. subjekata koji učestvuju, biti proizvedeni od samih učesnika.

Molimo obratite pažnju da se samo izražena interesovanja posla do 28.11.2019 i samo u potpunosti popunjene aplikacije se mogu uzeti u obzir za ocenjivanje.

- Da biste aplicirali treba dostaviti:
  - Aplikaciju popunjenu osnovnim podacima subjekta koji aplicira; i
  - Potrebne dokumente.
- Potrebni dokumenti za apliciranje:
  - Dokaz da je aplikant registrovan u Republici Kosovo;
  - Dokaz o aktivnom računu u jednoj od banaka licencirana od strane Centralne Banke Kosova;
  - Kopija lične karte ovlašćenog lica aplikanta;
  - Uverenje Suda da ovlašćenice subjekta nije pod istragom (potreban je original, ne stariji od 30 dana);
  - Izjava pod zakletvom;
  - Potvrda godišnjeg prometa aplikanta za fiskalnu godinu 2018 od strane Poreske Administracije Kosova; i
  - Poresko uvcenje aplikanta o izvršenim obavezama prema Poreskoj Administraciji Kosova, ne stariji od šest (6) meseci.

Molimo obratite pažnju da u nedostatku bilo kog dokumenta koji se zahteva na gore navedenoj listi, aplikacija aplikanta će biti diskvalifikovana i neće se dalje razmatrati za specifične kriterijume navedene u nastavku.

- Deset (10) učesnika bit će odabrani prema sledećim specifičnim kriterijumima i tačkama rangiranja:
  - Proizvode koje će aplikant pružiti potencijalnim kupcima na sajmu, maksimalno deset (10) poena: jedan (1) poen za jedan (1) proizvod, tri (3) poena za dva proizvoda, pet (5) poena za tri (3) proizvoda, sedam (7) poena za četiri (4) proizvoda i deset (10) poena za pet (5) ili više proizvoda;
  - Poznavanje stranih jezika i veština prezentacije predstavnika subjekta koji učestvuju na sajmu, maksimalno deset (10) kumulativnih poena: Engleski jezik pet (5) poena, Nemački jezik četiri (4) poena i drugi jezici jedan (1) poen;
  - Promotivni materijali na stranim jezicima, maksimalno deset (10) kumulativnih poena: na Engleskom jeziku četiri (4) poena, na Nemačkom jeziku četiri (4) poena i dva (2) poena na drugim Evropskim jezicima;
  - Države u kojima su proizvodi aplikanta izvezeni tokom 2018 i 2019, maksimalno deset (10) kumulativnih poena: države članice EU pet (5) poena, države Zapadnog Balkana koje nisu članice EU (Albanija, Bosna i Hercegovina, Srbija, Crna Gora i Makedonija) tri (3) poena i druga tržišta dva (2) poena;
  - Međunarodna sertifikacija aplikanta, maksimalno pet (5) kumulativnih poena: HACCP dva (2) poena, ISO 22000 dva (2) poena i druge relevantne sertifikacije jedan (1) poen;
  - Prezentacija aplikanta na sajmovima u poslednje tri (3) godine, maksimalno pet (5) poena: jedan sajam jedan (1) poen, dva (2) sajmovi dva (2) poena, tri (3) sajmovi tri (3) poena, četiri (4) sajmovi četiri (4) poena i pet (5) i više sajmovi pet (5) poena;
  - Godišnji promet aplikanta tokom fiskalne godine 2018, maksimalno deset (10) poena: od nule do 500.000 evra četiri (4) poena; od 500.001 do 1.000.000 evra osam (8) poena i preko 1.000.000 evra deset (10) poena;

Dana 25.11.2019, u 14:00 časova, u sali za sastanke KIESA, službenici KIESA će odgovoriti na pitanja o sajamskoj organizaciji i podršci kompanijama za učešće na ovom sajmu. Subjektima kojima je potrebna asistencija u popunjavanju ovog obrasca savetuje se da takođe prisustvuju ovom sastanku.

Subjekti koji žele da apliciraju za učešće na sajmu treba da izraze svoje interesovanje popunjavanjem aplikacije i poslati najkasnije do 28.11.2019 u kancelariji Arhive Ministarstva Trgovine i Industrije, Ulica: Muharrem Fejza, Bolnički okrug, bb Priština, 10000, Republika Kosovo.

U trenutku apliciranja, subjekat prihvata sve odgovornosti, obaveze, kriterije i dužnosti predviđene važećim zakonima i posebnim kriterijumima predviđenim u ovom javnom pozivu.

Informacije i upitnik za izražavanje interesovanja mogu se dobiti na KIESA-MTI ili preuzeti sa veb stranice mtj.rks-gov.net i kiesa.rks-gov.net ili na e-mail adresi export.kiesa@rks-gov.net.



SHOQATA E PRODHUESVE  
TË QUMËSHIT TË KOSOVËS  
KOSOVO ASSOCIATION OF  
MILK PRODUCERS KAMP

SHPQK /Shoqata e Prodhuesve të Qumështit të Kosovës shpall:

## KONKURS

**Për plotësim vendin e punës:**

**Pozita** -Zyrtar për mostrim (marrjen e mostrave të qumështit ) për nevojat e e projektit "Transparenca dhe Neutraliteti".

**Kualifikimet minimale, përvoja e punës dhe aftësitë profesionale:**

- Diplomë Universitare -Fakulteti i Bujqësisë & Veterinarisë (drejtimi-Veterinari, **Bioteknologji me Zooteknikë** i preferuar) apo i ngjajshëm.
- Përvoja e punës profesionale (2 vjet e dëshirueshme);
- Aftësi në përdorimin e kompjuterit,veçanërisht programeve MS Word dhe Excel.
- Patent shoferi kategoria B e obliguar (minimum 2 vjet pervoje ne vozitje )
- Njohja (zotërim) të gjuhës angleze – e dëshirueshme;

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin një biografi profesionale(CV)në formatin e EU <http://europass.cedefop.europa.eu/europass/home/hornav/Downloads/EuropassCV/CVTemplate.csp> dhe një letër motivuese.

Dokumentet duhet dërguar në e-mailin:

shpqkkamp@gmail.com ose [transparenca.neutraliteti@gmail.com](mailto:transparenca.neutraliteti@gmail.com)

Vetëm kandidatët e përzgjedhur për listen e ngushtë(te preferuar nga regjioni i Mitrovicës) do të kontaktohen.

Data e fundit për pranimin e aplikacioneve është **20.11.2019**.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "SKAB" Sh.p.k Mitrovicë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Mitrovicë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 10.12.2019 në ora 11:00 në hapësirat e zyrës së kompanisë "SKAB" sh.p.k rruga "Bislim Bajgora" pn, pran stacionit hekurudhor në Mitrovicë do të organizohet debat publik nga kompania "SKAB" Sh.p.k Mitrovicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Mitrovicë.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

### Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: **"Bajram Curri" vendi Romaje**  
Komuna: **Prizren**  
Data: **14.11.2019**

|                             |  |
|-----------------------------|--|
| Numri i kontratës:          | Emri i kontratës:                                      |
| <b>ESIP/SDG/82 – CS/1.2</b> | <b>Shetitje 3 / tre/ ditore me nxenes ne Brezovice</b> |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP)*, dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollën e **SHFMU "Bajram Curri" Romaje Komuna Prizren**. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i sherbimeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i sherbimeve të nevojshme:

- Shetitje 3 /tre/ ditore me nxenes ne Brezovice me karakter edukativo-arsimor dhe rekreativo-sportiv

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e sherbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve të referencës në adresën: Adresa e Shkolles: **SHFMU "Bajram Curri" Romaje, KK Prizren**, më së largu deri më **22.11.2019**

4. Termet e Referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur FPO Ftesë për ,oferte do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsultenteve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentet lutën që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**

**Personi kontaktues: Refki Demaj**  
**Telefoni: 044/113-196**  
**E-maili: [refki-demaj@hotmail.com](mailto:refki-demaj@hotmail.com)**

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

